

# ANALIZË STATISTIKORE E TREGUESVE TË INSPEKTIMIT

VITI 2019

*Kryeinspektor*

*Arben Seferaj*

## I. PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>II</b>
<b>HYRJE</b> .....	<b>III</b>
<b>MISIONI</b> .....	<b>iii.1</b>
<b>DEKLARATA E MISIONIT</b> .....	<b>iii.2</b>
<b>DETYRAT E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE</b> .....	<b>iii.3</b>
<b>QËLLIMI DHE METODOLOGJIA</b>	
<b>QËLLIMI</b> .....	<b>iv.1</b>
<b>METODOLOGJIA</b> .....	<b>iv.2</b>
<b>ARRITJET E FUNDIT TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE</b> .....	
<b>PËRGJEGJËSI SPECIFIKE</b> .....	<b>v.1</b>
<b>RAPORTIME SIPAS DEPARTAMENTEVE</b> .....	<b>VI</b>
<b>PËRBËRJA ORGANIZATIVE DHE ORGANIGRAMA</b> .....	<b>vi.1</b>
<b>DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (PERSONELI)</b> .....	<b>vi.2</b>
<b>INFORMACION I FINANCËS</b> .....	<b>vi.3</b>
<b>PUBLIKIME</b> .....	<b>VII</b>
<b>PROBLEMATIKAT TË HASURA</b> .....	<b>VIII</b>
<b>OBJEKTIVAT PËR VITIN PASARDHËS.</b> .....	<b>IX</b>

## **II.PËRMBLEDHJE**

Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si një organ i qeverisjes qendrore, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, që në vitin 1994, nëpërmjet veprimtarisë inspektuese të zhvilluar e përmirësuar në kohë, kërkon zbatimin e legjislacionit të punës nga të gjithë, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Kjo sfidë, na ka bërë të orientojmë si duhet dhe ku duhet inspektimin e punës. Kështu, inspektimet janë drejtuar në aktivitete me numër të madh punëmarrësish, duke shënuar vazhdimisht rritje në mesataren e vendeve të punës të inspektuara për subjekt. Ky raport do të analizojë të dhënat mbi veprimtarinë e inspektimit të mbledhura nga tabelat e trguesve statistikore për periudhën janar-dhjetor 2019.

## **III.HYRJE**

Ky raport është hartuar në bazë të kërkesave të ligjit 10433, datë 16.06.2011”*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, dhe do të përmbledhë aktivitetet dhe arritjet e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në bazë të objektivave të vëna përgjatë vitit 2019.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka realizuar gjithsej 13079 inspektime në subjekte Private dhe Shtetërore ose 782 inspektime më shumë se një vit më parë.

Janë konstatuar 1299 punëmarrës informal më shumë se një vit më parë dhe 1279 punëmarrës informale më shumë se një vit më parë janë formalizuar gjatë kontrolleve të ushtruara nga inspektorët e punës.

Në 27 % të inspektimeve të kryera janë vendosur masa administrative për shkeljet e konstatuara. Vlen të theksohet se përqindjen më të lartë të subjekteve me dënime administrative (*paralajmërim, gjoba, pezullime*) e zënë inspektimet për shkak aksidenti me 78.6% dhe inspektimet për shkak ankese me 48 %.

Në këtë kuadër platforma "Matrica e Dënimeve", e implementuar gjatë vitit 2019 po jep rezultate konkrete për një orientim dhe ndihmë për inspektorët e punës, për përdorimin efikas të dënimeve administrative.

65 kërkesa të subjekteve janë adresuar pranë ISHPSHSH-së për pajisje me Autorizim për punë të kryer në orë shtesë, punësim të të miturve nën 18 vjeç si dhe leje pune para fillimit të punës në ndërmarrje, nga të cilat 37 % e tyre kanë ardhur përmes aplikimit në faqen zyrtare të ISHPSHSH-së, duke i zhvilluar të gjitha këto kërkesa si inspektime me njoftim paraprak, sipas dhe përmirësimit të trajtimit të këtyre procedurave në kuadër të Reformës së Derregulimit.

## **iii.IMISIONI**

Misioni i përgjithshëm i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është: kontrolli, konstatimi, këshillimi, njoftimi, formimi, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe sanksionimi. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ngarkohet:

- ✓ Të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen

ngushtë me to, në atë masë, që inspektorët e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave.

- ✓ T'u japë të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efektive të shqyrtimit të dispozitave ligjore.
- ✓ Të vërë në dijeni autoritetin përgjegjës për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes.

### **iii.2 DEKLARATA E MISIONIT**

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqëror duke zbatuar misionin e tij, siguron të udhëheqë promovimin e përgjegjshmërisë dhe integritetit të sistemit të inspektimit në zbatim të legjislacionit të punës. Me qëllim mbrojtjen e interesave publike dhe interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë.

### **III.3 DETYRAT E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kryen këto funksione:

- ✓ kryen inspektime me qëllim vlerësimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit duke përmbushur indikatorët e performancës;
- ✓ dokumentimi i praktikave të mira në respektim të kërkesave ligjore dhe përhapjen e tyre;
- ✓ urdhërimi për korrigjimin e shkeljeve të kërkesave ligjore dhe pasojave që rrjedhin prej tyre;
- ✓ koordinimi me Drejtoritë e Inspektoratit Shtetëror të Punës;
- ✓ koordinimi i inspektimit dhe lehtësimi me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit

## **IV. QËLLIMI DHE METOLOGJIA**

### **iv.1 QËLLIMI**

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si një faktor i rëndësishëm i tregut të punës, ka udhëhequr e drejtuar punën, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së Legjislacionit të Punës. .

**Sigurimi i zbatimit të dispozitave ligjore, konkretisht:**

- ✓ për kushte pune të denja,
- ✓ mbrojtje e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre,
- ✓ për ligjshmëri në zbatimin e kohëzgjatjes së punës,
- ✓ pagesës për punë të kryer konform legjislacionit,
- ✓ sigurimit të çdo punëmarrësi,
- ✓ higjienës dhe mirëqenies në vendin e punës,
- ✓ punësimit të ligjshëm të fëmijëve,

- ✓ si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me marrëdhënien e punës, kanë qenë pjesë e punës në çdo subjekt të kontrolluar.

#### **Këshillimi teknik i punëdhënësve dhe punëmarrësve për:**

- ✓ Dispozitat ligjore ekzistuese dhe ato të dala së fundmi, si mjete efikase në punën e përditshme e konform ligjit,
- ✓ punën me kontratë si një marrëveshje ndërmjet palëve, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e tyre.

## **iv.2 METODOLOGJIA**

Metodologjia për hartimin e këtij raporti është bazuar mbi kontrollet dhe të dhënat statistikore të inspektimeve të kryera nga Degët Rajonale, si dhe mbi analizat e Drejtorive të ISHPSHSH-së: si Drejtoria e Inspektimit për Marrëdhëniet e Punës dhe Statistikën, Drejtoria e Inspektimit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore.

## **V.ARRITJET E FUNDIT TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka punuar në arritjen e objektivave si:

- ✓ Ndër objektivat për vitin 2019 përmendim rritjen e standarteve në bërjen efiçente të inspektimit, përmes punës në portalin “e-Inspektimi”, duke sjellë dhe rritjen e profesionalizmit të inspektorit të punës, për përmirësimin e nivelit të zbatimit të legjislacionit të punës e treguesve të inspektimit në punë.
- ✓ Realizimin e matricës së dënimeve.
- ✓ Rritjen e besueshmërisë, nëpërmjet trajtimit dhe dhënies zgjidhje të ankesave të ardhura nga punëmarrës dhe punëdhënës.
- ✓ Minimizimin e punës informale nëpërmjet forcimit të kontrollit, dhe marrjes së masës urgjente “pezullim” për çdo punëmarrës të evidentuar në punë pa siguracion, dhe sigurimin e tij konform legjislacionit, pa të cilin nuk lejohet të vazhdojë punën.
- ✓ Orientimin e kontroleve në inspektime rastësore, në turne të dytë të tretë dhe festa zyrtare.
- ✓ Orientimin e kontroleve drejt aktiviteteve ekonomike që paraqesin rrezikshmëri të lartë për siguri e mirëqenie në punë të punëmarrësit.
- ✓ Forcimin e kontrollit në sektorët e shërbimeve sidomos gjatë sezoneve turistike duke organizuar kontroll në Hotel-Bar-Restorante, kryesisht në sezonet e nxehta (Korrik-Gusht), me synim minimizimin e formave të punësimit që vijnë në kundërshtim me Legjislacionin e Punës, (në vëmendjen tonë punësimit i të miturve), minimizimi i punësimit pa kontrata pune sipas një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës konform Legjislacionit të Punës.
- ✓ Monitorimin e vazhdueshëm të punës ndaj gjithë strukturës inspektuese, duke ofruar mbështetje për kryerjen në mënyrë sa më korrekte të detyrës.
- ✓ Monitorimi, analizimi dhe vlerësimi i dosjes së hetimit të aksidentit në punë të kryer nga inspektorët rajonalë.

- ✓ Këshillimi, kontrolli dhe zbatueshmëria e ligjit dhe luftimi i informalitetit gri, në operacionin anti-informalitet.
- ✓ Mbajtja e regjistrit të aksidenteve në punë dhe arshivimi i dokumentacionit të aksidenteve në punë.
- ✓ Në kuadër të realizimit të të gjitha detyrimeve që rrjedhin në zbatim të MSA- së, Kartës Sociale, Konventave të ILO-s të ratifikuara nga Parlamenti Shqiptar dhe Rekomandimeve të BE-së, është bërë mbajtja e statistikave sipas klasifikimeve të ILO-s dhe kërkesave të BE-së, raportim periodik në kuadër të MSA-së, raportim për Kartën Sociale.
- ✓ Evidentimi i mangësive të punës së zhvilluar nga Drejtoritë Rajonale të ISHPSHSH-së nga roli monitorues.
- ✓ Zbatimi i të gjitha detyrave të tjera që dalin gjatë muajve.
- ✓ Inspektimin online tashmë i shtrirë në çdo qark.

## **v.1 PËRGJEGJËSI SPECIFIKE**

Hartimi i këtij raporti, bazohet në të dhënat e inspektimeve të realizuar nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së, në 12 Degët Rajonale ku ajo ka shtrirje si dhe përpunimi dhe analizimi i këtyre të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme.

Të dhënat e inspektimit përfshijnë:

Numrin e inspektimeve të realizuar nga çdo inspektor pune, i çdo Dege Rajonale, sipas llojit të inspektimit të kryer. Inspektimet e realizuara nga ISHPSHSH-ja, përfshijnë inspektimet e programuara (sipas planeve mujore), si dhe inspektimet e realizuara jashtë planifikimi, ku përfshihen:

- Inspektimet e realizuara pas çdo rasti ankese të depozituar në Degë Rajonale apo Drejtori Qendrore,
- Inspektimet e realizuara pas çdo rasti denoncimi të marrë për aksident në punë.
- Inspektimet e realizuara si raste inspektimi rastësor.

Në inspektimet e planifikuara përfshihen inspektimet e planifikuara për tematika si:

- Riinspektimet, e realizuara kryesisht për evidentimin e realizimit të detyrave të lëna, me afate kohore, e për raste specifikisht delikate.
- Inspektimet e realizuara në turne të dyta e të treta, realizuar kryesisht në muaj e lloj aktiviteti ku ndeshet dhe është më e evidente.
- Inspektimet e realizuara në ditët e festave zyrtare apo ditët e pushimit javor, ku ka indicie që punohet.
- Inspektimet e realizuara pas kërkesave të bëra, për punësim të miturish, për evidentimin e kërkesave specifike ligjore për këtë kategori punëmarrësish.

Të dhënat e inspektimeve të realizuara nga ISHPSHSH, bazuar dhe në instrumentat ndërkombëtare lidhur me Inspektimin e Punës përfshijnë kryesisht:

- Konventën e ILO-s Nr. 81 “Inspektimi i Punës”,
- Konventën e ILO-s Nr. 129 “Inspektimi i Punës në Bujqësi”,

- Konventën e ILO-s Nr. 155 "Siguria dhe Shëndetit në Punë"

Kështu të dhënat statistikore të vizitave inspektuese përfshijnë:

- Numrin e subjekteve të inspektuara sipas:
  - llojit të inspektimit të kryer,
  - llojit të aktivitetit ekonomik,
  - klasifikimit sipas llojit të inspektimit, të realizuar në turne të dytë, të tretë apo ditët e festave zyrtare.
- Të dhëna mbi klasifikimin e personave të punësuar sipas kritereve burra, gra, femijë, të huaj, me aftësi të kufizuar, që kryejnë punën në shtëpi, që punojnë me kohë të pjesshme etj.
- Të dhëna kryesore mbi ligjshmërinë e të punësuarve, me kontrata individuale pune apo jo, të futur në skemën e sigurimeve shoqërore apo jo, të siguruar me pagë minimale apo jo etj.
- Statistika të aksidenteve në punë që tregojnë pikërisht numrin e aksidenteve të deklaruara dhe të dhënat mbi klasifikimin e këtyre aksidenteve:
  - a. Sipas industrisë.
  - b. Numrin e aksidenteve me pasoje vdekje ose jo
- Statistika të shkeljeve ligjore dhe të sanksioneve që tregojnë pikërisht:
  - a. Numrin e subjekteve, sipas llojit të aktivitetit, të "pezulluara" për shkelje të dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës.
  - b. Numrin e subjekteve, sipas llojit të aktivitetit, të "pezulluara" për shkelje të dispozitave ligjore të sigurisë dhe shëndetit në punë.
  - c. Numrin e subjekteve, sipas llojit të aktivitetit, të sanksionuara me gjobë.

Për përmbushjen e detyrimeve ligjore e për një monitorim të vazhdueshëm të punës inspektuese, të dhënat e mësipërme raportohen çdo muaj, nga Kryeinspektori i Degës Rajonale, nëpërmjet tabelave statistikore, si dhe monitorimi i tyre nga portali e-inspektimi si dhe monitorimi nga trupat e Drejtorisë Qendrore.

Analizimi i këtyre të dhënave në rang vendi, e krahasimisht me degët rajonale, nëpërmjet specifikimeve e rekomandime për treguesit e mësipërm, shërben, në evidentimin, sipas rajoneve apo llojit të aktivitetit, të shërbimit të inspektimit.

## **VI. RAPORTIMI SIPAS DEPARTAMENTEVE**

Drejtorja e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, pranë ISHPSHSH-së, është një strukturë e bashkëngjitur Inspektoriatit të Punës që nga viti 2012. Më parë kjo Drejtori ka qenë

pjesë e SHSSH ( Shërbimi Social Shtetëror) që nga viti 2005, me kompetenca të plota për inspektimin e shërbimeve të përkujdesit shoqërore në rang kombëtar, bazuar në Ligjin 9355 dt.10.03.2005, dhe VKM-të përkatëse të Ligjit. Struktura aktuale e saj përbëhet nga 5 punonjës, (1 Drejtor dhe 4 Inspektorë).

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, kjo drejtori duhej të shkëputej nga Inspektoriati i Punës dhe të fuqizohej duke u krijuar si strukturë më vetë në varësi të Ministrit përgjegjës të fushës së shërbimeve të kujdesit shoqëror. Gjithashtu, bazuar në VKM Nr. 508 datë 13.09.2017 “Për Përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore duhet të transferohet nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky proces transferimi dhe fuqizimi është në pritje të miratimit të VKM-ve përkatëse.

Drejtorja e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Drejtorja e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore ka përgjegjësi të kontrollojë dhe të verifikojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Drejtorja e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore ka si detyrë kryesore inspektimin e të gjithë strukturave të shërbimit, duke filluar nga bashkitë (Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore, shërbimet komunitare, shërbimet në familje, kujdestaritë), shërbimet rezidenciale, ditore, shërbimet e kujdestarisë familjare, shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve nga NjMF-të, ndërmarrjet sociale, si dhe çdo lloj shërbimi komunitar, për respektimin e standarteve të miratuara me VKM.

Vlerësimi i standarteve për subjektet që duhet të liçensohen.

Inspektimi i ankesave dhe kërkesave të përfituesve dhe strukturave, të cilat kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Vlerësimi i nevojave sociale kryesore të komunitetit në nevojë në bashkëpunim me strukturat e pushtetit vendor.

Mbajtja, përditësimi i një baze të dhënash për shërbimet, subjektet, njësitë vendore, NjMF-të si dhe inspektimet e kryera.

### **Orientimi i inspektimeve ka synuar:**

Minimizimin e punës informale nëpërmjet forcimit të kontrollit, dhe marrjes së masës administrative “pezullim” për çdo punëmarrës të evidentuar në punë pa siguracion, dhe sigurimin e tij konform legjislacionit, pa të cilin nuk lejohet të vazhdojë punën. Të dhënat e inspektimeve të kësaj periudhe tregojnë se nga 2879 punëmarrës informal të konstatuar nga të cilët tashmë 2794 ose 97 % e tyre, janë bërë pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore brenda procesit të inspektimit.

- 847 prej tyre janë konstatuar në inspektime e hapura si çështje të programuara,
- 1814 konstatuar në çështje inspektimi të hapura në sistem si çështje në periudha piku të aktiviteteve, kryesisht periudhë e sezonit turistik, në aktivitetet e hoteleri



- turizmit, orientim tashmë i përvitshëm ky i ISHPSHSH-së, nisur nga sezoni dhe garantimi i punës së sigurt e të siguruar.
- 206 punëmarrës informal të konstatuar në rastet e inspektimeve si çështje ankese, të bërë pranë ISHPSHSH-së,
  - 12 konstatime të punëmarrësve të pasiguruar në rastet e inspektimeve si çështje aksidenti në punë.
- ✓ Rritja e besueshmërisë, nëpërmjet trajtimit dhe dhënies zgjidhje të ankesave të ardhura nga punëmarrës dhe punëdhënës.
  - ✓ Orientimi i kontroleve drejt aktiviteteve ekonomike që paraqesin rrezikshmëri të lartë për siguri e mirëqenie në punë, të punëmarrësit.
  - ✓ Monitorimi i vazhdueshëm i punës, ndaj gjithë strukturës inspektuese, duke ofruar mbështetje për kryerjen në mënyrë sa më korrekte të detyrës.
  - ✓ Rritjen e kujdesit shoqëror komunitar, në respektim të standarteve të reja për tipologji, por edhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve në përputhje me nevojat e gjithë komunitetit.
  - ✓ Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, garantimi i respektimit të shërbimeve me qëllim respektimin e të drejtave të përfituesit dhe mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna dhe abuzimi, duke vlerësuar prioritet forcimin e mekanizmave, procedurave të mbrojtjes si dhe rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj procesit të ankimimit.

Në shërbim të përmirësimeve të vazhdueshme në punën inspektuese, përta i takon zbatimit të plotë dhe gjithpërfshirës të legjislacionit të punës:

ISHPSHSH-ja ka lançuar “Matricën e Dënimeve” si një platformë e aksesueshme në Faqen Zyrtare të institucionit. Kjo platformë, jep ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve profesionale të inspektorëve të punës, duke mundësuar orientim të qartë në legjislacionin e punës. Gjithashtu përmes saj, sigurojmë një proces inspektimi krejt transparent duke ulur në maksimum abuzimin me detyrën nga inspektorët e punës.

Përmirësimet e domosdoshme të sistemit e-Inspektimi, për kryerjen e verifikimeve dhe dokumentimin online, të çdo veprimi inspektues, kanë bërë të mundur tashmë marrjen në kohë reale të dokumenteve E-sig 025 dhe E-sig 027, për deklarimet e subjekteve në tatim-taksa si për NIPT ashtu dhe për NID.

Tashmë, sistemi mundëson kryerjen e inspektimeve edhe në subjekte të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre, pa deklaruar adresën sekondare apo nënkontraktore, duke vepruar e ndërhyrë menjëherë për mos abuzime të çdo kujt, në lidhje me sigurinë e shëndetin në vendin e punës .

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 332 inspektime tematike mbi aplikuesit e programit **IPARD II** 2014-2020. Për aplikuesit pas procedurës së inspektimit u është dorëzuar dhe certifikata që verteton përpuethshmërinë e subjektit me standartet e BE-së për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas parashikimeve në legjislacionin e BE-së dhe atë shqiptar në lidhje me investimin dhe me

standaret e sigurisë në punë, bazuar në inspektimin e kryer nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në objekt.

### **Analizimi i të dhënave nga inspektimet e kryera**

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka kryer gjithsej 13079 inspektime në subjekte Private dhe Shtetërore dhe 782 inspektime më shumë se një vit më parë.

*Të dhënat e inspektimeve realizuar në vite :*

	Private dhe Shtetërore			Vetëm Private		
	Inspektime	Nr i Punëmarresve	Mesatare e vendeve të punës për subjekt	Inspektime	Nr i Punëmarresve	Mesatare e vendeve të punës për subjekt
<b>Viti 2016</b>	11299	219114	19.4	11235	210320	18.7
<b>Viti 2017</b>	7958	182154	22.9	7923	176744	22.3
<b>Viti 2018</b>	12297	291244	23.6	12222	272296	22.3
<b>Viti 2019</b>	13079	296,808	22.6	13015	282,782	21.7

Gjatë këtyre muajve janë trajtuar 834 ankesa/kërkesa nga të cilat 600 ankesa të ndjekura me inspektim-ankese të cilat nga ana sasiore zënë 5% të inspektimeve e kontrolleve të zhvilluara në këtë periudhë ose 133 inspektime më shumë se një vit më parë me vizita inspektuese.

### **Të dhënat e inspektimeve 2019:**

Analiza e rezultateve të inspektimeve për vitin 2019, janë pjesë e kontrolleve të kryera nga 84 inspektor pune në terren. Vlen të theksohet se, gjatë viti 2019 ka pasur shume vende vakante nga të cilat 8 inspektor pune kane filluar punë ne fund të vitit 2019 dhe nuk kanë kryer inspektime.

Janë 10256 subjekte të inspektuara ose 78.4%, janë realizuar, si inspektime të planifikuara, nga 13079 subjekte të inspektuara gjithsej nga ISHPSHSH-ja.

*(Llogaritjet e mëposhtme janë kryer duke përfshirë edhe me inspektorët të cilët kanë filluar punë në fund të vitit por nuk kanë inspektime, për ata që janë me leje dhe ata që janë larguar gjatë vitit)*

<i>Degët Rajonale</i>	<b>Inspektime Total</b>	<b>Inspektor pune</b>	<b>Mesatare Inspektime për inspektor gjatë Vitit 2019</b>	<b>Mesatare Inspektime për inspektor në muaj</b>
<i>Berat</i>	827	5	165	15
<i>Dibër</i>	354	2	177	16
<i>Durrës</i>	807	7	115	10.4
<i>Elbasan</i>	1012	8	127	12
<i>Fier</i>	1015	6	169	28
<i>Gjirokastrë</i>	314	3	105	10
<i>Korçë</i>	986	6	164	15
<i>Kukës</i>	544	3	181	16
<i>Lezhë</i>	556	4	139	13
<i>Shkodër</i>	1002	7	143	13
<i>Tiranë</i>	4,514	33	137	12
<i>Vlorë</i>	1148	6	191	17
<i>12 Degët Rajonale</i>	13079	90	144	13

### Të dhënat e inspektimeve janë:

<b>Lloji i inspektimit</b>	<b>Subjekte të inspektuara</b>	<b>Subjekte me dënime administrative (paralajmërim, gjoba, pezullime)</b>	<b>% e subjekteve me dënime administrative kundrejt totalit të inspektimeve për çdo rast</b>	<b>Punëmarrës pa kontrata pune dhe të pasiguruar</b>
<b>Inspektime të programuara</b>	10256	1824	18%	2763
<b>Inspektime për shkak aksidenti në punë</b>	197	157	78.6%	270
<b>Inspektime për shkak ankese</b>	600	287	48%	417
<b>Inspektime rastësore (shkelje flagrante evidente)</b>	2026	1305	64%	3787
<b>Total Inspektime</b>	13079	3573	27%	7237
<b>27 % e inspektimeve janë inspektime me dënime administrative</b>				

90% e inspektimeve rastësore, janë kryer në periudhën korrik, gusht, shtator 2019 realizuar në aktivitetet e hoteleri turizëm me periudhë sezoni turistik.


Të dhënat mbi inspektimet sipas llojit të inspektimit, për degë rajonale janë:

Degët Rajonale	Inspektime të programuara (planifikim apo kërkesa)	Inspektime për shkak aksidenti në punë	Inspektime për shkak ankese	Inspektime rastësore (indicia për shkelje flagrante)	% e inspektimeve jashtë plani kundrejt totalit të inspektimeve
Berat	535	9	10	<b>273</b>	33.00%
Dibër	271	19	4	60	23%
Durrës	481	26	54	246	40%
Elbasan	805	16	21	170	20%
Fier	928	8	19	60	9%
Gjirokastrë	296	10	-	8	5.70%
Korçë	813	9	11	153	18%
Kukës	360	8	2	174	34%
Lezhë	418	15	17	106	24.80%
Shkodër	798	9	25	170	20%
Tiranë	3607	60	386	461	20%
Vlorë	944	8	51	145	18%
<b>Total</b>	10256	<b>197</b>	<b>600</b>	<b>2026</b>	22%

Krahasimisht me të dhënat e një viti më parë kemi, numër të shtuar të rasteve të inspektimeve rastësore për indicje të shkeljeve flagrante të ligjit, si dhe për shkak ankese.

	Inspektime rastësore/për indicje të shkeljeve flagrante	Inspektime për shkak ankese
<i>Viti 2018</i>	314	467
<i>Viti 2019</i>	2026	600
<i>raste më shumë këtë vit se një vit më parë</i>	<b>1712 më shumë</b>	<b>133 Më shumë</b>

Inspektime jashtë programimi, përbëjnë 22% kundrejt totalit të inspektimeve të realizuar në periudhën janar-dhjetor 2019, ku të analizuarat për degë rajonale rezultojnë:



**Disa nga treguesit e përgjithshëm statistikorë të inspektimeve realizuar gjatë vitit 2019 nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së janë:**

	Viti 2018	Viti 2019
Subjekte të inspektuara Private + Shtetërore	12297	13079
Vende pune të inspektuara	291244	296808
Punëmarrëse femra	140834	147542
Mesatare e punëmarrës për subjekt	23.6	22.6
Subjekte private të inspektuara	12222	13015
Vende pune të inspektuara në subjektet private	272296	282782
Punëmarrëse femra	140837	142239
Mesatare e punëmarrës për subjekt në subjekte private	22.2	21.7
Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	3661	4358
Punëmarrëse femra pa kontrata individuale	1443	1706
Punëmarrës informal të evidentuar	1580	2879
Punëmarrëse informale femra të evidentuar	467	994
Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH	1515	2794
Punëmarrëse informale femra të futur në skemën e SSH	467	970
Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	329	255
Punëmarrëse femra nën 18 vjeç të evidentuara	154	88
Punëmarrës të huaj të evidentuar	2074	1106
Punëmarrës të huaj, pa leje pune	20	18


Punëmarrës me aftësi të kufizuar	324	195
Punëmarrëse femra me aftësi të kufizuar	74	59
Subjekte për të cilët është mbajtur masë administrative “Pezullim” për shkelje të dispozitave ligjore të marrëdhënieve të punës	844	1568
Subjekte për të cilët është mbajtur masë administrative “Pezullim” për shkelje të dispozitave ligjore të sigurisë e shëndetit në punë	11	151
Subjekte me masën administrative “Paralajmërim”	1538	1692
Subjekte me masën administrative “Gjobë”	175	160
Vlera totale e sanksioneve (lekë)	28914	38162.2
Inspektime të programuara	11354	10256
Inspektime për shkak Ankese	467	600
Inspektime për shkak Aksidenti	162	197
Punëmarrës të aksidentuar	195	176
Punëmarrëse femra të aksidentuara	30	24
Punëmarrës të aksidentuar me vdekje	27	38

Aktivitetet ekonomike të inspektuara kjo rezultat i llojit të aktiviteve që operojnë më së shumti në Shqipëri dhe orientimit për shkak të sezonit, janë në masën 46% aktivitete Tregëti, hotel-bar-restorante.

Më konkretisht të dhënat në shifra rezultojnë:

Lloji i aktivitetit	Inspektime
Bujqësi pyje peshkim	284
Miniera karriera	296
Ndërmarrje prodhuese	2,822
Elekticitet gaz ujë	134
Tregëti H-B-R	6,010
Ndërtim	1,315
Transport, telekomunikacion	241
Financë shërbime të sigurimeve	124
Aktivitete të tjera	1,853
<b>Total</b>	<b>13,079</b>

### Inspektime sipas llojit të aktivitetit Viti 2019




Orientimi i inspektimeve, bazuar në analiza të të dhënave nga inspektimet e mëparshme, duke vlerësuar nivelin e riskut për subjekt, llojin e aktivitetit për periudha kohore e nevojën për treg pune, rastet e përsërituara të ankesave e aksidenteve në punë, çuan në rritjen e masave administrative të marra në inspektimet e realizuara, për subjekte të inspektura në periudhat respektive kohore.


Domosdoshmëria e zbatimit të dispozitave ligjore nga të gjithë subjektet ekonomike, e patoleruar në kurriz të punëmarrësve, ka sjell dhe rritjen e forcës goditëse të inspektorit të punës, në 1002 subjekte më shumë me masa se një vit më parë.

<i>Periudhat e inspektimeve</i>	<i>Viti 2018</i>	<i>Viti 2019</i>
Subjekte të Inspektuara	12297	13079
Masa administrative të aplikuar	2568	3573
Përqindje e subjekteve me masa administrative kundrejt subjekteve të inspektuara	21%	27%

Përqindje e subjekteve me masa administrative kundrejt subjekteve të inspektuara, në 12 degët rajonale rezulton:



### Përqindje e dënimeve administrative sipas llojit të aktivitetit



Masat administrative, ndaj subjekteve të inspektuara, sipas rastit e llojit të inspektimit, janë më ndëshkuese në inspektimet e aksidenteve në punë, ankesave dhe inspektimeve rastësore, ku 79% e



inspektimeve për aksident në punë janë me masa të tilla, dhe 48 % e inspektimeve për shkak ankese, janë me masa administrative dhe 64% e inspektimeve rastësore kanë shkuar me gjobë.

	Inspektime	Subjekte me masa administrative	Përqindje e subjekteve me masa kundrejt inspektimeve përkatëse
Në inspektime të programuar	10256	1824	18%
Në inspektime për aksident në punë	197	157	79%
Në inspektime për shkak ankese	600	287	48%
Në inspektime rastësore (shkelje flagrante)	2026	1305	64%

Një shpërndarje e masave administrative për lloj aktiviteti, sipas masës së marrë janë:

Viti 2019	Pezullim/për shkelje të dispozitave ligjore për marrëdhënie pune	Pezullim/ për shkelje të dispozitave ligjore për sigurinë në punë	Subjekte me Paralajmërim	Subjekte me gjobë	Vlerë (000 në lekë)
Bujqësi pyje peshkim	6	-	9	1	260
Miniera kariera	9	34	108	12	5,472
Ndërmarrje prodhuese	176	13	467	51	10,318
Elektricitet gaz ujë	15	-	33	3	1,300
Tregeti H-B-R	1,110	10	563	25	4,787
Ndërtim	106	90	257	32	9,294
Transport, telekomunikacion	10	1	38	-	-
Financë, shërbime të sigurimeve	8	-	4	1	260
Të tjera	128	3	215	35	6,471
<b>Total</b>	<b>1,568</b>	<b>151</b>	<b>1,694</b>	<b>160</b>	<b>38,162.2</b>

Për masa administrative të marra apo shkelje të dispozitave ligjore lënë në vendim përfundimtar të inspektimit, çdo subjekt, ka të drejtën e ankimit. Pranë ISHPSHSH-së gjatë këtij viti janë ankimuar 53 vendime inspektimi ku 45 ose 85 % e tyre janë lënë në fuqi, nga komisioni i apelimit, pranë ISHPSHSH-së. Janë shfuqizuar 6 sanksione(gjobë) dhe ndryshur vetëm 1 sanksion paralajmërim. Për ato vendime për të cilat Komisioni i Ankimit të Gjobave, ka vendosur shfuqizim, u është dërguar rast pas rasti tërheqje vëmendje inspektorëve që kanë trajtuar këto praktika inspektuese, për zbatimin në mënyrë sa me rigorozë të Legjislacionit të Punës.

Gjatë vitit 2019 sektori juridik, ka ndjekur dhe vazhdon të ndjekë 44 procese gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me sanksionet e vendosura subjekteve të ndryshme, si dhe me marrëdhëniet e punës.

Kështu janë fituar për këtë periudhë 23 procese gjyqësore , 4 procese gjyqësore janë humbur, dhe 18 procese janë në vazhdim duke u ndjekur.

Të gjitha proceset gjyqësore janë ndjekur në mënyrë korrekte dhe siç pasqyroam pjesa më e madhe këtyre gjyqeve janë fituar. Nënvizojmë se gjykatat janë institucione të pavarura që rregullohen e funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe me ligj të veçantë. Vetë legjislacioni e parashikon ankimin në gjykatë si mjetin në shkallë më të lartë hierarkie pas procedurës administrative që kryejnë organet e administratës. Vlen për tu përmendur që edhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe funksionimin e gjykatave administrative”, ka përcaktuar 6 gjykata administrative për 12 qarqe dhe si vlerë për ankimim në shkallë mbi 10 fish të pagës minimale.

Të ardhurat nga gjobat gjatë kësaj periudhe nga vjelja e gobave dhe kamatvonesave janë në vlerën 26.697.878 (njëzet e gjashtëmilionë e gjashtëqind e nëntëdhjet e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjet e tetë ).

### Inspektime për aksident në punë

Për periudhën janar-dhjetor 2019 janë regjistruar dhe për të cilët ka përfunduar hetimi administrativ i aksidentit në punë për **166 raste të aksidenteve**, ku janë lënduar gjatë punës në të gjitha llojet e aktiviteteve **176 punëmarrës** prej të cilëve **38 me pasojë të humbjes së jetës**.

Për 76% të punëmarrësve të aksidentuar shkaqet lidhen drejtpërdrejtë me kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe 76.3% e aksidenteve me pasojë fatale për jetën kanë ndodhur për këto shkaqe.

	VITI 2019	
	Punëmarrës të aksidentuar	Te aksidentuar me vdekje
<b>AKSIDENTE</b>	<b>176</b>	<b>38</b>
Aksidente që lidhen direkt me punën	134	29
Aksidente që lidhen direkt me punën (pa minierat)	108	23
Aksidente në rrugë	26	5
Aksidente në miniera	26	6
Aksidente për shkaqe të tjera, të palidhura drejtpërdrejt me punën	16	4

Nisur nga shkakut e ndodhjes së tyre, në tabelën më lart janë specifikuar rastet kur aksidenti i ndodhur ka ardhur si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e kushteve të punës, si edhe rastet kur ngjarja vlerësohet për shkak të ligjit si aksident në punë, duke i trajtuar punëmarrësit nga skema e sigurimeve si të aksidentuar gjatë punës. 24 % e punëmarrësve të aksidentuar në punë janë aksidentuar për shkaqe të ndryshme nga ato të kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë. **Nësë zbresim rastet e aksidenteve në miniera, të cilat nuk janë në kontrollin e drejtpërdrejtë të**

***inspektorit të punës, aksidentet që lidhen drejtpërdrejt me punën dhe që janë nën kontroll të inspektorit të punës përbëjnë 61.3% të rasteve.***

Kështu, sqarohet se:

- Në subjektet me aktivitet miniera, karriera janë regjistruar 26 punëmarrës të aksidentuar në punë, nga të cilët 6 me pasoja fatale për jetën. Këto subjekte janë objekt kontrolli nga ana e ISHPSHSH-së, ku inspektori i punës konfirmon rastet e aksidenteve të ndodhura në punë, por verifikimi i kushteve të sigurisë dhe shëndetit në nëntokë, kryhet nga AKSEM (Autoriteti Kombëtar i Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera). Në rastet e aksidenteve në punë në këto subjekte, inspektori i punës plotëson “Provesverbalin e Aksidentit në Punë” në bazë të relacionit të mbajtur nga ky institucion (AKSEM), i cili përcakton edhe shkakun e ndodhjes së ngjarjes dhe rregullat e shkelura.
- Në bazë të ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” vlerësohen si aksidente në punë edhe rastet kur aksidenti ka ndodhur rrugës në linjën e drejtpërdrejtë nga banesa për në punë dhe anasjelltas, si në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësi ashtu edhe individualisht nga punëmarrësi, si edhe rastet kur gjatë kryerjes së punës janë goditur nga një automjet. Këto përbëjnë 26 raste të aksidentuarve të ndodhura ose 14.7 % të aksidenteve të ndodhura, 5 prej të cilëve me pasojë të humbjes së jetës ose 13% të rasteve të aksidenteve me vdekje.
- Në grupimin “Raste të aksidenteve për shkaqe të tjera, të palidhura drejtpërdrejt me punën” janë shënuar rastet të tilla si:
  - Gjendja shëndetësore e punëmarrësve, jo sëmundje e përgjithshme, ku gjatë orarit të punës kanë pësuar infarkt, marrje mendsh. Janë regjistruar 5 punëmarrës në këtë gjendje, ku 2 prej të cilëve, infarkti ka sjellë humbje të menjëhershme të jetës. Përgjithësisht këto raste kanë ndodhur në përfundim apo menjëherë me fillimin e punës dhe është konstatuar që mungonte raporti mjekoligjor apo mbulimi i subjektit me shërbim mjekësor.
  - Goditje nga persona të tretë për shkak të detyrës, ku janë regjistruar 3 raste, në aktivitete “Të tjera”, ku punëmarrësit (meshkuj) me pozicion pune: punonjës në një zyrë këmbimi valutor, roje sigurie, apo inspektor i administratës shtetërore janë goditur nga persona të tjerë. Këto janë raste pa pasojë fatale për jetën, por me pasoja të rënda për shëndetin, duke shkaktuar paafësi mbi 20 ditë /2muaj.
  - Kushteve atmosferikë të kohës, ku dy nga katër rastet e ndodhura me këtë natyrë, rezultuan me pasoja fatale për jetën. Ishin punëtorë mirëmbajtje dhe shitës karburanti, ku era shume e fortë ka sjellë dëme materiale dhe në njerëz.
  - Janë 2 raste ku punëmarrësit janë sulmuar nga kafshë dhe si pasojë kanë pësuar thyerje apo shembje në pjesë të ndryshme të trupit.
  - Raste të ndodhur mësueseve ku pengohen nga nxënës dhe rrëzohen apo nga trembja në rastet e pasgoditjes së tërmetit rrëzohen duke vrapuar për të dalë jashtë.

Duke zbritur këto raste të cituara më sipër, ***aksidente të ndodhura gjatë punës dhe që lidhen drejtpërsëdrejti me kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë janë 134 punëmarrës, ose 108 nëse zbrisim edhe aksidentet në miniera, të cilat nuk monitorohen në nëntokë nga ISHPSHSH.***

➤ Moshë mesatare e punëmarrësve të aksidentuar është 38.

## 1.2 Aksidentet me pasojë vdekje

38 punëmarrës kanë humbur jetën gjatë vitit 2019, të cilët janë vlerësuar si raste aksidenti në punë. 76.3% e aksidenteve me pasojë fatale për jetën kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me punën, ardhur si pasojë e ngjarjeve të ndodhura gjatë kryerjes së punës sipas përshkrimit të saj. Degët Rajonale ku ushtronin aktivitet këto subjekte renditen sipas numrit më të lartë të aksidenteve me vdekje: Tiranë (9 punëmarrës me pasojë vdekje), Lezhë (5 punëmarrës me pasojë vdekje), Elbasan, Shkodër (4 punëmarrës me pasojë vdekje), Durrës, Dibër, Gjirokastrë (3 punëmarrës me pasojë vdekje); Berat, Korçë (2 punëmarrës me pasojë vdekje); Kukës (1 punëmarrës me pasojë vdekje).

***Aksidentet me vdekje që lidhen drejtpërdrejtë me punën përbëjnë 21.6 % të punëmarrësve të aksidentuar (duke përfshirë aksidentet në rrugë dhe ato për shkaqe të palidhura dpd me punë.*** Nga 29 punëmarrës që kanë pësuar vdekjen si pasojë e shkaqeve që lidhen drejtpërdrejtë me punën, 65.5% e tyre kanë ndodhur në sektorin e ndërtimit, 20% e tyre janë punëmarrës minator të cilët kanë gjetur vdekjen në nëntokë, 6.9 % në sektorin e “Elektricitet, gaz, ujë” dhe 6.9% në “Ndërmarrjet prodhuese”, më pak në sektorin “Të tjera” dhe “Tregti”.

80 % e inspektimeve për shkak aksidenti në punë me pasojë vdekje janë sanksionuar me dënim administrativ kryesor, ndërsa rastet për të cilat nuk është vendosur sanksion janë ato që nuk lidhen drejtpërdrejtë me punën apo kur hetimi administrativ është i lidhur me hetimin penal.

Në 5 raste inspektimi ka qenë për herë të parë, ai i inspektimeve për aksidente në punë ku është regjistruar punëmarrës me pasojë vdekje. Nisur nga detyrat e lëna që përkojnë me gjetjet e konstatuara si shkelje në subjekt në kohën e ndodhjes së aksidentit rezulton se në këto raste janë evidentuar mungesë të një vlerësimi të risqeve, mospërdorim i pajisjeve mbrojtëse individuale, mospërcaktim i qartë i rregullave të sigurimit teknik, mungesa e pajisjeve mbrojtëse individuale, mungesa e informimit të punëmarrësve.

6 nga punëmarrësit e aksidentuar me shkak vdekje kanë rezultuar punëmarrës të padeklaruar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shendetësore.

4 nga aksidentet me pasojë vdekje nuk janë njoftuar në kohë nga subjektet, apo njoftimi nga ana e tyre ka munguar.

Në 74% të inspektimeve me pasojë vdekje të punëmarrësve, inspektorët e punës kanë bashkëpunuar për hetimin administrativ të rastit me organet e Policisë apo/dhe Prokurorisë; me Autoritetin Kombëtar të Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera; me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial; Spitalin dhe Institutin e Mjeksisë Ligjore.

## 1.3 Aksidentet masive

Janë regjistruar **8 raste të aksidenteve masive**, të ndodhura në 10 subjekte, ku kanë mbetur të lënduar 18 punëmarrës, nga të cilët 3 me pasojë humbje jete. Vlen të theksohet se 4 punëmarrës

që janë prekur në aksidentet masive janë aksidentuar në nëntokë(miniera) dhe 2 punëmarrës janë aksidentuar si pasojë e aksidentit automobilistik.

Aksidentet masive janë regjistruar nga Degët Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë, Dibër, Durrës dhe Lezhë, Elbasan, Berat. Raste të aksidentve masive, janë shënuar si në formën e prekjës së disa subjekteve nga e njëjta ngjarje, ashtu edhe në atë që në të njëjtën gjarje janë aksidentuar dy apo më shumë punëmarrës. Rastet e aksidenteve masive (duke zbtitur rastin e aksidentit automobilistik) përbërjé kështu 4.2 % të rasteve të aksidenteve të ndodhura.

#### **1.4 Aksidentet e përsëritura në të njëtin subjekt**

Duke përjashtuar rastet të cilat kanë ndodhur në rrugë dhe që nuk kanë lidhje të drejtëprdrejtë me kushtet e punës, aksidentet e përsëritura në të njëjtën subjekt dhe në të njëjtin vend të ushtrimit të aktivitetit janë regjistruar në 3 subjekte dhe konkretisht në “OSHEE”(2 raste), “Albchromë” Dibër (9 raste) dhe “Tete Albania&Mining” (2 raste). Vlen të theksohet që rastet e aksidenteve në “Albchrome” dhe “Tete Albania&Mining” janë shënuar në nëntokë, subjektet në fjalë kryejnë aktivitetet minerar. Kështu rastet e aksidenteve të përsëritura përbëjnë 1.8% të subjekteve të prekura nga aksidentet , ose 7.8% të rasteve të ndodhura të aksidenteve.

Edhe në subjektet shtetërore, më aktivitet “Të tjera” janë regjistruar raste të aksidenteve të përsëritura, por shkaqet e tyre nuk janë të lidhura me mungesën e kushteve të sigurisë dhe shëndetit në vendim e punës.

#### **1.5 Aksidente në grupe të riskuara / mbrojtje të veçantë**

##### **a) Femra të aksidentuara**

26 nga punëmarrësit e aksidentuar janë *femra*, pa pasoja fatale për jetën, me shtetësi shqiptare. Mosha mesatare e femrave të aksidentuara është 40. Sektorët në të cilët janë shënuar këto raste janë përgjithësisht në subjektet me aktivitet “ Ndërmarrje prodhuese” dhe kryesisht në fasoneri, si dhe aktivitete “Të tjera”. Pozicioni i tyre i punës përgjithësisht ishte sanitare, mësuese, shitëse, punëtore, rrobaqepëse, juriste, pjatatarëse, punonjëse pastiçerie, mjekë.

12 nga rastet e ndodhura nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, nisur nga shkaku i ndodhjes së tyre, ku mund të përmendim:prania e ngricave në ambjetet e shkollës që ka sjellë rrëshkitje; aksidente rrugore nga puna për në shtëpi dhe anasjelltas, penguar nga një nxënës dhe rrëzohet, sulmimi nga një qen, ku edhe pasojat më të rënda mbi 2 javë janë shënuar në këto raste.

Aksidente të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me kushtet e punës ku janë aksidentuar femra përbëjnë 8% të punëmarrësve të aksidentuara.

Përsa i përket llojit të dëmtimit kanë pësuar frakturë në duar, këmbë dhe mjekër.

Si shtrirje gjeografike, këto subjekte kanë ndodhur në Tiranë, Durrës, Fier dhe Korçë, Lezhë, Vlorë.

23% e rasteve të aksidenteve në të cilat janë aksidentuar punëmarrëse femra, janë të panjofuara nga subjekti.

Në 92% të këtyre rasteve që lidhen drejtpërdrejtë me punën, ndaj subjekteve janë marrë dënime administrative kryesore gjobë ose paralajmërim, ndërsa në rastet në të cilat janë lënë vetëm detyra për realizim janë përgjithësisht ato, kur ngjarja e ndodhur nuk lidhej drejtpërdrejtë me kushtet e punës.

**b) Nuk ka pasur raste të fëmijëve të aksidentuar gjatë punës.**

**c) Nuk ka pasur persona me aftësi të kufizuar të aksidentuar gjatë punës.**

**d) Punëmarrës të huaj**

Janë regjistruar dy punëmarrës të huaj të aksidentuar, të cilët ishin punëmarrës në minierë, në zonën e Dibrës, pa pasoja fatale për jetën. Ishin të pajisur me leje pune.

**1) Ulja e numrit të punëmarrësve të aksidentuar në punë.**


Kështu:

- Për vitin **2018** janë regjistruar 194 punëmarrës të aksidentuar.
- Për vitin **2019** janë regjistruar 176 punëmarrës të aksidentuar

Krahasimisht, me një vit më parë janë konfirmuar si punëmarrës të aksidentuar në punë 18 punëmarrës më pak.

Edhe nëse zbresim për të dy vitet rastet e aksidenteve të cilat kanë ndodhur në rrugë apo për shkaqe të tjera jo të lidhura me natyrën e punës së zakonshme, regjistrohet ulje e numrit të punëmarrësve të aksidentuar. Kështu:

- Për vitin **2018** janë regjistruar si aksidente të lidhura drejtpërdrejtë me punën 151.
- Për vitin **2019** janë regjistruar si aksidente të lidhura drejtpërdrejtë me punën 134.



2) Ulja e rasteve të aksidenteve masive (ku të paktën dy apo më shumë punëmarrës dëmtohen në të njëjtën kohë dhe për shkak të së njëjtës arsye) .

Për vitin **2019** janë regjistruar 8 raste të aksidenteve masive, të cilat përbërje kështu 4.2 % të rasteve të aksidenteve të ndodhura.

Ndërsa për vitin **2018** aksidentet masive përbëjnë 4.8% të rasteve të aksidenteve të ndodhura.

3) Aksidentet e përsërituara në të njëjtin subjekt më shumë se një herë nuk përbëjnë një fenomen, pasi krahasimisht me vitet e shkuara vërehet ulje e këtyre rasteve.

- Për vitin **2019** aksidentet e përsëritura përbëjnë 7.8 % të rasteve të ndodhura.
- Për vitin **2018** aksidentet e përsëritura përbëjnë 7.2% të rasteve.
- Për vitin **2017** aksidentet e përsëritura përbëjnë 23.2% të rasteve.
- Për vitin **2016** aksidentet e përsëritura përbëjnë 21% të rasteve.
- Për vitin **2015** aksidentet e përsëritura përbëjnë 46.25 % të rasteve.
- Për vitin **2014** aksidentet e përsëritura përbëjnë 37.7% të rasteve.
- Për vitin **2013** aksidentet e përsëritura përbëjnë 24% të rasteve.

Rritja e forcës ndërkuese të inspektorit të punës në rastet e inspektimit të subjekteve ku kanë ndodhur aksidente në punë, duke shënuar numër më të lartë të masave administrative të marra gjatë hetimit të aksidenteve.

Inspektime për shkak aksident Viti 2019								
Deget Rajonale	Inspektime per aksident	Pezullim/ Marredhen ie pune	Pezullim/S iguri ne punes	Paralajmërim	Gjobë	Vlerë (.000)	Punemarres /aksidentuar	Punemarres/ Aksidentuar me vdekje
Berat	9	0	1	4	2	1040	8	2
Dibër	19	0	0	12	2	360	21	3
Durrës	26	2	3	19	8	1162	21	3
Elbasan	16	0	3	11	4	1080	16	4
Fier	8	0	0	2	3	460	8	2
Gjirokastrë	10	0	1	0	2	150	6	3
Korçë	9	0	0	3	2	360	8	2
Kukës	8	0	0	3	2	360	6	1
Lezhë	15	3	1	5	6	2090	13	5
Shkodër	9	0	0	1	5	1770	7	4
Tiranë	60	2	3	7	26	6572	53	9
Vlorë	8	0	0	7	2	150	9	0
<b>Total</b>	<b>197</b>	<b>7</b>	<b>12</b>	<b>74</b>	<b>64</b>	<b>15554</b>	<b>176</b>	<b>38</b>

Sipas degëve rajonale kemi që numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë është kryer në degën rajonale Tiranë, Durrës, Dibër dhe Lezhë

Punëmarrës janë trajtuar 1 në inspektime te programuara 2 për shkak ankese , 1 në rastësor dhe 172 janë trajtuar në inspektime për shkak aksidenti.

Sa i takon inspektimeve për aksident në punë rezultojnë se në 38% të rasteve të inspektimit për shkak aksidenti është marrë masa administrative “Paralajmërim”, dhe në 32.4 % të rasteve është marrë masa administrative “Gjobë”.

<b>Sipas llojit të aktivitetit ekonomik rastet e aksidenteve në punë rezultojnë: i viti 2019</b>	Subjekte të inspektuara për shkak aksidenti në punë	Punëmarrës të aksidentuar	Punëmarrës të aksidentuar, me vdekje
<i>Bujqësi, pyje ,peshkim</i>	1	1	-
<i>Miniera, karriera</i>	25	27	7
<i>Ndërmarrje prodhuese</i>	48	39	2
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	12	9	3
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	17	12	4
<i>Ndërtim</i>	49	45	17
<i>Transport, telekomunikacion</i>	3	1	-
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	-	-	-
<i>Aktivitete të tjera</i>	42	42	5
<b>Total</b>	<b>197</b>	<b>176</b>	<b>38</b>

- **Inspektime për shkak ankese**

Ankesat e ardhura drejt Institucionit tonë si shkak i ndërgjegjësimit të punëmarrësve dhe punëdhënësve, janë gjithnjë e në rritje, ku në total gjatë kësaj periudhe, janë trajtuar 834 ankesa nga të cilat 600 ankesa me procedurë inspektimi. Edhe denoncime të tjera janë trajtuar pa procedurë inspektimi por me të gjithë seriozitetin e duhur, duke dhënë informacionin e nevojshëm sipas rastit dhe delegim në autoritet përkatëse sipas fushës së kompetencës dhe specifikës që paraqitej.

Sa i takon zgjidhjes nuk është parë vetëm dhënia e të drejtës personit që adreson denoncimin, por dhe luftimi i fenomenit, i cili përmirëson marrëdhënien e punësimit për punëmarrësit që prekeshin nga e njëjta problematikë.

Sa i takon inspektimeve për shkak ankese rezultojnë se në 53 subjekte ose në 8.8 % të rasteve është marrë dënim kryesor “Gjobë”, ndërkohë në 153 subjekte ose në 25.5 % të këtyre inspektimeve është marrë dënim kryesor “paralajmërim”.

Sipas regjistrimit të ankesave për vitin 2019 rezultojnë të regjistruara dhe të trajtuara 834 ankesa gjithsej të ardhura kryesisht nga punëmarrës, ish-punëmarrës, punëdhënës dhe qytetarë. Kjo



shifër është 14 % më e lartë së numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2018 dhe 38 % më e lartë se ankesat e ardhura gjatë vitit 2017, gjë që flet për një rritje të autoritetit të institucionit. Marrëdhëniet e punës dhe puna në kushte të sigurta dhe të shëndetshme është një sfidë e madhe që inspektorëve të punës u duhet të përballën, në një treg punësimi në dinamikë të vazhdueshme. Adresimi i problematikave nga ankuesit ka ndikuar në përmirësimin e planifikimit të inspektimeve, pasi identifikon lehtësisht dhe llojet e aktiviteteve si dhe abuzimet më të shpeshta, për të fokusuar kontrollin dhe synuar rritjen e efektivitetit të këtij të fundit.

Sipas të dhënave kemi një rritje të numrit të ankesave të drejtuara dhe trajtuara nga Degët Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe nga Drejtoria Qendrore, ndërkohë që Degët e tjera kanë pak a shumë të njëjtin rritëm me një vit më parë.

Vetëm 33 % e ankesave janë paraqitur drejtëpërsëdrejti në protokollin e Degëve Rajonale, pasi 559 ose 67% e ankesave/denoncimeve/kërkesave janë depozituar pranë Drejtorisë Qendrore dhe janë ndjekur me delegim në Degët Rajonale, duke patur një ngarkesë jo të vogël si Sektor për administrimin e të gjithë rasteve të ankesave. Nga këto 391 raste kanë ardhur përmes adresave zyrtare [Ankesa.Sli](#) dhe [Info.Sli](#) , që aksesohen në faqen zyrtare [inspektoriatipunes.gov.al](http://inspektoriatipunes.gov.al).

Sipas të dhënave kemi një rritje të numrit të ankesave të drejtuara dhe trajtuara nga Degët Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe nga Drejtoria Qendrore, ndërkohë që Degët e tjera kanë pak a shumë të njëjtin rritëm me një vit më parë.

Për shkak të kësaj ngarkese gjatë 6-mujorit të dytë të viti ka funksionuar pjesa e monitorimit të rasteve të ankesave nga të gjithë inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme sipas delegimit këtyre të fundit rast pas rasti. Në këtë kuadër vlen të theksohet se nuk ka patur asnjë rast me tejkalim të afatit për përgjigje të pajustificuar, që do të thotë që mekanizmi i ndjekjes së ankesave ka funksionuar më së miri. Mbetet punë për të përmirësuar cilësinë e trajtimit dhe sidomos kthimin e përgjigjes .

Rëndësi i kemi kushtuar monitorimit të trajtimit të ankesave, duke angazhuar të gjithë inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të ISHPSHSH-së. Në këtë kuadër vlen të theksohet se nuk ka patur asnjë rast me tejkalim të afatit për përgjigje të pajustificuar, që do të thotë që mekanizmi i ndjekjes së ankesave ka funksionuar më së miri. Pavarësisht se ka përmirësim shumë të madh në ezaurimin e fakteve për të patur përgjigje shteruese, mbetet punë për të përmirësuar cilësinë e trajtimit dhe sidomos në konceptimin e kthimit të përgjigjes të qartë dhe të kuptueshme për qytetarët/punëmarrësit ankues.

Ankesat e adresuara sipas llojit të ankimit janë pasqyruar në grafikun e mëposhtëm;

### Shpërndarja e ankesave sipas arsyes së ankimit



40.3 % e arsyes së adresimit të ankesës, lidhet me cënimin e marrëdhënieve të punës, ku kryesisht lidhen me mosrespektimin e kontratës së punës. Mund të themi me bindje se tashmë kemi një ndërgjegjësim, sa i takon formalizimit të këtij dokumenti, ndërkohë që numri më i madh i bizneseve të mesme dhe të vogla, vijojnë të përdorin kontrata tip, duke mosreflektuar specifika të vetë natyrës së aktivitetit që zhvillojnë, të cilat bëhen shkak për një konflikt mes palëve.


72 ankesa janë adresuar për zgjidhje me arsyen e mosderdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për punëmarrësit. Pavarësisht se referohen 72 ankesa, numri i punëmarrësve që preken nga kjo shkelje është shumë herë më i madh.

22.5 % i përkasin adresimit të kërkesave për informacion, interpretim apo sqarime në lidhje me çështje të ndryshme të punësimit.

76 % e ankesave janë zgjidhur plotësisht apo pjesërisht në favor të ankuesve, për të gjithë elementët që rezultuan brenda kompetencës së inspektorit të punës për zgjidhje. Pjesa tjetër është deleguar rast pas rasti në Autoritet Përgjegjëse ose është sqaruar situata ligjore e ankuesit/denoncuesit.

Numri i ankesave të adresuara nga Platforma e Bashkëqeverisjes "Shqipëria që duam", kundrejt ISHPSHSH-së, për vitin 2019 ka qenë 104 ankesa gjithsej nga të cilat 22 janë raste të ankesave të biznesit. Nga këto 62% janë zgjidhur, ndërkohë që 10 raste kanë rezultuar raste suksesi. Këtu vlen të përmendim rastin e adresuara kundrejt subjektit "Minerva"shpk me aktivitet Agjensi Punësimi, që rezultoi se kryente procesin e ndërmjetësimit kundrejt pagesës, në kundërshtim me ligjin. Ky rast u ndoq dhe u referua dhe pranë Seksionit të Krimin Ekonomik dhe qytetarit iu kthye shuma e paguar nga ky i fundit.

Sipas Zgjidhjes i kemi në Grafikon e mëposhtëm:



### Inspektime për ankesë Viti 2019

Deget Rajonale	Inspektime për shkak anekese	Pezullim/shkelje flagrante të marrëdhënie të punës	Pezullim/shkelje flagrante të sigurisë në punë	Masë administrative Paralajmerim	Masë administrative Gjore	Vlere (.000)
<i>Berat</i>	10	1	0	9	0	0
<i>Diber</i>	4	0	0	1	0	0
<i>Durres</i>	54	4	0	24	9	3160
<i>Elbasan</i>	21	4	0	8	2	520
<i>Fier</i>	19	1	0	7	0	0
<i>Gjirokaster</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Korçë</i>	11	0	1	1	1	52
<i>Kukës</i>	2	1	0	0	1	2002
<i>Lezhë</i>	17	4	1	10	2	362
<i>Shkodër</i>	25	5	0	0	3	1030
<i>Tiranë</i>	386	47	6	65	30	6428
<i>Vlorë</i>	51	6	0	28	5	400
<b>Total</b>	<b>600</b>	<b>73</b>	<b>8</b>	<b>153</b>	<b>53</b>	<b>13954</b>

Numri më i madh i ankesave të trajtuara këtë vit është realizuar nga Dega Rajonale Tiranë me 386 inspektime për shkak ankese, Dega Vlorë me 51 inspektime, Dega Durrës me 54, etj.

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik, inspektimet e kryera per rast ankese janë:

Lloji i aktivitetit	Subjekte të inspektuara për shkak ankese	Punëmarrës	Pa kontrata	Informal	U siguruan	Pnm me pagë minimale
<i>Bujqësi, pyje ,peshkim</i>	2	44	-	-	-	32
<i>Miniera, karriera</i>	9	1,472	15	15	2	16
<i>Ndërmarrje prodhuese</i>	146	24,471	71	60	49	4,387
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	5	1,466	-	-	-	50
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	129	2,546	40	41	41	477
<i>Ndërtim</i>	27	756	11	9	9	112
<i>Transport, telekomunikacion</i>	18	1,375	12	11	11	230
<i>Financë, shërbime të sigurimeve</i>	13	1,020	4	4	4	31
<i>Aktivitete të tjera</i>	251	30,024	58	66	60	2,332
<b>Total</b>	600	63,174	211	206	176	7,667

- **Kontrata individuale të punës në subjektet private:**

Janë evidentuar në total 4358 punëmarrës pa kontrata pune në subjektet private dhe shtetërore nga të cilët 4155 punëmarrës janë evidentuar në aktivitetet private të inspektuara ose 1.4% e totalit të punëmarrësve që janë konstatuar gjatë inspektimeve kontrata pune individuale në subjektet private.


Më konkretisht, numri i punëmarrësve evidentuar në punë pa kontrata pune individuale në 12 prefekturat e vendit në subjekte private është:

**Degët Rajonale      Aktivitete private të inspektuara Janar-Dhjetor**

		Subjekte	Punëmarrës	Punëmarrës pa kontrata	% e Punëmarrësve pa kontrata
1	Berat	820	12055	211	2%
2	Dibër	346	10166	102	1%

3	Durrës	803	28514	221	0.70%
4	Elbasan	1006	12374	250	2%
5	Fier	1013	19619	43	0.20%
6	Gjirokastrë	309	3468	235	6.70%
7	Korçë	985	12447	207	1.60%
8	Kukës	539	3239	276	8.50%
9	Lezhë	551	9574	305	3%
10	Shkodër	1000	14918	226	1.50%
11	Tiranë	4508	136211	542	0.30%
12	Vlorë	1135	20197	1537	7.60%
	SHUMË	13015	282782	4155	1.40%

Punëmarrës pa kontrata pune individuale kundrejt totalit të punëmarrësve të evidentuar në aktivitetet private të inspektuara, sipas degëve rajonale



Duke analizuar të dhënat mbi punëmarrësit e evidentuar pa kontrata pune individuale në llojet e aktiviteteve të kontrolluara rezulton gjatë vitit 2019 në inspektimet e kryera nga ana sasiore numri më i lartë i punëmarrësve që punonin pa kontrata pune individuale është konstatuar në aktivitetet tregëtare, bar-hotel-restorante:

Këto rezultate paraqiten si më poshtë:

Lloji i aktivitetit	Inspektime (subjekte private)	Punëmarrës	Pa kontrata	Pa kontrata Femra	% e punm. pa kontrata individuale
Bujqësi, pyje, peshkim	284	1,519	54	53	4%
Miniera, karriera	294	11,636	56	6	0.48%
Ndërmarrje prodhuese	2817	121,791	644	388	0.5%
Elektricitet, gaz, ujë	118	9,061	17	5	0.18%
Tregti, hotel-bar-restorante	6010	49,007	2526	961	5.1%
Ndërtim	1314	22,315	461	25	2%
Transport, telekomunikacion	241	5,623	94	36	1.6%
Finance, shërbime të sigurimeve	123	2,137	14	4	0.6%
Aktivitete të tjera	1814	59,693	289	106	0.48%
<b>Total</b>	13015	282,782	4155	1574	1.4%

- **Punësimi informal :**

Një ndër indikatorët e matshëm në fushën e inspektimit ngelet informaliteti. Ashtu si detyra dhe misioni i çdo inspektori ngelet udhëheqja nga kërkesat e përcaktuara në politikën e zbatimit të inspektimit, për të gjitha rregullat dhe objektivat në mënyrë të njëtrajtshme , të barabartë dhe transparente ndaj të drejtave të punëmarrësve që respektojnë ligjin. Duke krijuar një praktikë të mirë inspektimi që do të thotë krijimi i një mjedisi pune të mirë, produktive, të sigurt në respekt të normave të së drejtës që të jep ligji.


Gjatë inspektimeve të realizuara në gjatë vitit 2019, janë evidentuar të punojnë të pasiguruar, gjithsej 2879 punëmarrës, për të cilët pas marrjes së masave administrative “pezullim”, deri në përfshirjen e tyre në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, gjatë procesit të inspektimit, janë siguruar 2794 prej tyre. ku minimumi i kostos së munguar në arkën e shtetit për sigurim shoqëror e shëndetësor **për një muaj**, për këta punëmarrës, në 20.8 milion lekë.

Këtë vit periudha e sezonit turistik ku konsiston dhe me numrin më të madh të informalëve të evidentuar, është rezultat i planit operacional të ndërmarrë, ku është operuar me inspektime të trupës inspektuese në zona gjeografike me aktivitet të shtuar gjatë sezonit turistik. Inspektimet nuk ishin në grupe të përbashkëta me dëgët e tatim-taksave, por me mbështetjen e tyre në koordinimin veprimesh, e shkëmbim informacioni.

Inspektimet janë kryer edhe në ditët e pushimit javor, dhe në orët e turneve të dyta dhe të treta.

Të dhënat krahasuese me inspektimet e viteve të fundit, janë dukshëm për numër të shtuar të evidentimit dhe formalizimit të punësimit informal, pasi në vitet e tjera, nuk është operuar me lëvizje të trupës inspektuese, në zona gjeografike me aktivitet të shtuar sezonal.

### Të dhëna mbi informalitetin e konstatuar në vite



Lloji i inspektimit	Subjekte të inspektuara Privat+Shtet	Punëmarrës	Punëmarrës të pasiguruar	Punëmarrës të siguruar gjatë procesit
Inspektime të programuara	10256	197646	847	825
Inspektime për shkak aksidenti në punë	197	21784	12	9
Inspektime për shkak ankese	600	63174	206	176
Inspektime rastësore (shkelje flagrante evidente)	2026	14204	1814	1784
Total Inspektime	13079	296808	2879	2794

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik, informaliteti në aktivitetet **private** rezulton :

Lloji i aktivitetit	Inspektime (subjekte private)	Punëmarres	Punëmarrës të pasiguruar	Femra të pasiguruara
Bujqësi, pyje, peshkim	284	1,519	10	-
Miniera, karriera	294	11,636	37	5
Ndërmarrje prodhuese	2817	121,791	335	194
Elektricitet, gaz, ujë	118	9,061	16	5
Tregti, hotel-bar-restorante	6010	49,007	1,863	659
Ndërtim	1314	22,315	334	10

Transport, telekomunikacion	241	5,623	44	17
Finance, shërbime të sigurimeve	123	2,137	9	5
Aktivitete të tjera	1814	59,693	224	95
Total	13015	282,782	2,872	990

*Sipas degëve rajonale punëmarrësit informal të evidentuar janë:*

Degët rajonale	Punëmarrës të pasiguar Në subjekte private+shtetërore	Punëmarrës, siguar gjatë procesit të inspektimit
Berat	42	42
Dibër	65	65
Durrës	430	423
Elbasan	200	199
Fier	47	47
Gjirokastrë	16	16
Korçë	284	279
Kukës	287	240
Lezhë	139	139
Shkodër	216	207
Tiranë	654	640
Vlorë	499	497
Total	2879	2794

*Sipas degëve rajonale dhe emrave të inspektorëve informal të evidentuar janë:*

- **Paga**

Punësimi me pagë minimale rezulton evident në 31% të punëmarrësve të evidentuar në punë në aktivitetet private të inspektuara, e ku aktivitetet si: bujqësi, pyje peshkim, tregëti hotel-bar-restorante e transport telekomunikacion, ku sigurimi i punëmarrësve kryhet mbi pagë minimale, rezulton 49% të totalit të punëmarrësve të evidentuar për aktivitetet.

Lloji i aktivitetit	Inspektime (subjekte private)	Punëmarrës	Punëmarrës, siguar me page minimale	Punëmarrëse femra të siguruara me page minimale	Përqindje e punëmarrësve të siguar me page minimale
Bujqesi pyje peshkim	284	1,519	981	376	64.5%
Miniera kariera	294	11,636	901	120	7.7%
Ndermarrje prodhuese	2817	121,791	39,027	26,935	32%
Elektricitet gaz uje	118	9,061	500	108	5.5%



Tregeti H-B-R	6010	49,007	24,046	10,012	49%
Ndertim	1314	22,315	8,269	774	37%
Transport, telekomunikacion	241	5,623	2,460	910	44%
Finance sherbime	123	2,137	475	176	22%
Te tjera	1814	59,693	9,784	4,257	16%
<b>Total</b>	<b>13015</b>	<b>282,782</b>	<b>86,443</b>	<b>43,668</b>	<b>31%</b>

## • Gjoba

Përsa i përket dënimeve administrative, dënim me gjobë, në periudhën janar- dhjetor 2019 janë vendosur gjithsej 160 gjoba. Nga këto janë shqyrtuar nga Komisioni i Ankimit të Gjobave 53 ankimime. 45 prej tyre janë lënë në fuqi dhe janë shfuqizuar 6 gjoba. Është ndryshuar vendimi për 1 subjekt për të cilin inspektorët kishin përcaktuar dënimin administrativ "Paralajmërim". Në të gjithë rastet për të cilat Komisioni i Ankimit të Gjobave, ka vendosur shfuqizim, u është dërguar rast pas rasti, tërheqje vëmendje inspektorëve, që kanë trajtuar këto praktika inspektuese, për zbatimin në mënyrë sa më rigoroze të legjislacionit të punës.

Rritja e numrit të ankimimeve kundrejt vendimeve përfundimtare të inspektorëve të punës, të trajtuara nga Komisioni i Ankimit të Gjobave, me 6% krahasuar me një vit më parë, tregon për një rritje të ndërgjegjesimit të vetë subjekteve për ndjekur të gjitha etapat administrative të parashikuarara nga ligji, si dhe për efektet pozitive që po jep përmirësimi i infrastrukturës ndihmëse për aplikimin dhe komunikimin online, gjatë gjithë procedurës së ankimimit të vendimit përmes faqes zyrtare të ISHPSHSH-së duke bërë transparencë të të gjithë procesit.

## • Derregullimi

Nga inspektimet tematike në këtë periudhë janë 56 inspektime të realizura me njoftim paraprak në kuadër të lehtësimin dhe thjeshtezimit të procedurave, nga të cilat:

- 25 janë realizuar pas kërkesës së subjektit për autorizim punësimi të punëmarrësve të mitur nga ku rezulton të jenë autorizuar 40 punëmarrës të tillë.
- 13 janë realizuar për aprovim autorizimi për të punuar në orë shtesë nga te cilat 7 janë miratuar
- 18 inspektime janë realizuar për leje pune ku janë miratuar 5.

Degët Rajonale	Realizuar për autorizim për të mitur		Realizuar për autorizim orësh shtesë		Realizuar për autorizim për leje pune	
	Inspektime	Femijë që u autorizuan	Inspektime	Subjekte që u autorizuan	Inspektime	Subjekte që u autorizuan
Berat	0	0	1	0	0	0
Durrës	11	23	0	0	2	2

Elbasan	0	1	1	1	1	1
Korçë	0	0	3	2	0	0
Lezhë	0	0	1	1	0	0
Shkodër	6	9	0	0	1	0
Tiranë	6	1	7	3	6	1
Vlorë	2	6	0	0	8	1
<b>Total</b>	<b>25</b>	<b>40</b>	<b>13</b>	<b>7</b>	<b>18</b>	<b>5</b>

## RAPORT PËR PUNËN E ISHPSHSH-SË NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PLANIT OPERACIONAL DHE ANGAZHIMIT INSTITUCIONAL

Në kuadër të planit operacional në luftë kundër Informalitetit, dhe shkelësve të legjislacionit të punës, të ndërmarrë nga MFE, ISHPSHSH-ja nga 1 korrik 2019 deri më 31 dhjetor 2019 është angazhuar dhe ka orientuar punën në:

- ✓ inspektimet e subjekteve me aktivitet të shtuar në sezonin turistik veror 2019 e me risk të shtuar informaliteti të tregut të punës,
- ✓ inspektime drejt subjekteve të vlerësuara deri tani me risk të lartë e shumë të lartë sa u takon sigurisë dhe shëndetit në punë,

Si rezultat i zbatimit të “Planit Operacional”, deri tani janë:

- 6096 subjekte të kontrolluara gjithsej, që zënë 47% të totalit të inspektimeve të realizuara gjatë vitit 2019. Në 1213 subjekte të kontrolluara në këtë periudhë, që zënë 20% të totalit të kontrolleve, është konstatuar punësim informal. Për shkelje të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës janë marrë gjithsej 2184 masa administrative, apo në 36% të subjekteve të kontrolluara, për shkeljet e dispozitave ligjore të legjislacionit të punës grupet e inspektimit kanë marrë masa administrative të parashikuara në ligj, si pezullime, paralajmërim apo gjoba.

Konkretisht:

- a. për shkelje të dispozitave ligjore që lidhen me marrëdhëniet e punës, janë 1215 raste, masa administrative “pezullime” e që zënë numrin më të lartë të masave administrative, 56% të masave administrative aplikuar në kontrollet e kësaj periudhe. Rezultatet e këtyre masave administrative janë konkrete, me numrin e punëmarrësve, pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore tashmë.
- b. për shkelje të dispozitave ligjore që lidhen me sigurinë e shëndetin në punë të punëmarrësve janë 106 raste, masa “pezullime” aktiviteti, raste këto për kushte flagrante të shkeljeve të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës kryesisht në aktivitet ndërtues.
- c. 784 raste janë masa administrative “paralajmërim”, aplikuar në masën 13% të subjekteve të kontrolluara për shkelje të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës.

d. 79 raste janë masa administrative “gjobë” aplikuar në masën 1.3% të subjekteve të kontrolluara, për shkeje të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës. Mesatare e vlerës së gjobave të aplikuara gjatë kontrolleve është 10- fishi i pagës minimale miratuar me VKM, ndërkohë që parashikimet e legjislacionit të punës për shkelje të dispozitave ligjore janë 0-50 fishin e pagës minimale.

- Në këtë periudhë, për 132419 punëmarrës gjithsej, është verifikuar marrëdhënia e punësimit, kushtet e punës dhe siguria në punë. Gjatë kontrolleve, 2155 punëmarrës kanë rezultuar të punojnë të pasiguarur dhe të padeklaruar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore. Shifra e informalitetit të evidentuar është në masën 27% në 1213 subjektet të cilët kanë rezultuar me 7866 të punësuar gjithsej dhe që kanë mbartur problematikën e informalitetit. Informaliteti është më present në periudhën e sezonit turistik. (korrik-shtator).

Të gjitha subjektet e kontrolluara, janë këshilluar për zbatimin e legjislacionit të punës, si përmes lënies së këshillave në dokumentin e inspektimit ashtu dhe përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve informuese me të drejta dhe detyrime të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Në 64% e subjekteve të kontrolluara, nuk janë marrë masa administrative, por kanë qenë pjesë e këshillimeve dhe të detyrave konkrete të lëna për zbatim.

Rezultatet e inspektimeve të kësaj periudhe, krahas masave konkrete këshilluese e administrative, flasin për formalizimin e 2110 punëmarrësve informal, ku minimumi i kostos së munguar në arkën e shtetit për sigurim shoqëror dhe shëndetsor, sikur këto punëmarrës të jenë pjesë e kësaj skemë në vetëm 1 muaj me 26 mijë lekë pagë mujore minimale, shifra është 15.2 milion lekë. Pjesa tjetër prej 45 punëmarrësish që u konstatuan të punojnë të padeklaruar, për veprime të mëtejshme, janë deleguar pranë Degëve Rajonale të Tatim Taksave.

Në inspektimet e realizuara nga ISHPSHSH-ja gjatë këtij viti, rezultojnë 2879 punëmarrës informal, ku 75% e tyre rezulton të jenë evidentuar pikërisht gjatë planit operacional, dhe me masat e mara, vetëm gjatë procesit të inspektimit, rezultojnë të formalizuar gjithsej gjatë vitit 2019, 2794 punëmarrës, e ku kosto e shtuar në arkën e shtetit vetëm për 1 muaj, llogaritur me sigurim mbi pagë mujore minimale, është 20.2 milion lekë.

### **Ndërkohë të dhënat e inspektimeve sipas periudhave kohore rezultojnë:**

Të dhënat e inspektimeve	Inspektime Total	Nr i Punëmarrësve	Informal të konstatuar	Inspektime për ankesë	Inspektime rastësore	Inspektime për aksident
Total/Korrik	1,396	22,531	713	50	349	16
Total/Gusht	802	10,552	627	44	648	19
Total/Shtator	861	22,101	501	64	704	27

Total/Tetor	994	25,135	172	74	146	15
Total/Nentor	923	23,871	69	39	40	16
Total/Dhjetor	1120	28,229	73	61	14	21
Korrik-Dhjetor 2019	6.096	132,419	2155	332	1,901	114
<b>Ne perqindje</b>				<b>5.4%</b>	<b>31.2%</b>	<b>1.9%</b>

Sipas llojit të aktiviteteve ekonomike, rezulton se në përqindje, aktivitetet ku më së shumti ishte e nevojshme ndërhyrje me masa administrative, janë aktivitetet e miniera kariera elektricitet gaz ujë dhe aktivitetet e ndërtimi.

Lloje aktiviteti	Subjekte të Inspektuara	Subjekte me shkelje dhe masa administrative për këto shkelje	% e masave kundrejt inspektimeve
Bujqësi pyje peshkim	153	6	4%
Miniera kariera	113	54	48%
Ndërmarrje prodhuese	1,173	347	30%
Elektricitet gaz uje	63	33	52%
Tregeti H-B-R	3,244	1,251	39%
Ndertim	667	307	46%
Transport, telekomunikacion	73	23	32%
Finance sherbime	29	8	28%
Te tjera	581	155	27%
<b>Total</b>	<b>6,096</b>	<b>2,184</b>	<b>36%</b>

Aktivitete, me numrin më të lartë të informalitetit, evidentuar gjatë kontrolleve, janë aktivitetet tregtare, hotel-bar-restorante, aktivitetet ndërtuese si dhe ndërmarrje prodhuese.

Lloje aktiviteti	Subjekte të Inspektuara	Informal të evidentuar
<b>Bujqesi pyje peshkim</b>	153	5
<b>Miniera kariera</b>	113	9
<b>Ndermarrje prodhuese</b>	<b>1,173</b>	<b>173</b>
<b>Elektricitet gaz uje</b>	63	14
<b>Tregeti H-B-R</b>	<b>3,244</b>	<b>1,589</b>

<b>Ndertim</b>	<b>667</b>	<b>228</b>
<b>Transport, telekomunikacion</b>	73	25
<b>Finance sherbime</b>	29	6
<b>Te tjera</b>	581	106
<b>Total</b>	<b>6,096</b>	<b>2,155</b>

- **Inspektimi në Subjekte Fason**

Në fokus të inspektimeve kanë qenë dhe subjektet Fason ku janë realizuar 231 Inspektime ose 5% e inspektimeve në subjekte private, me një numër 24876 punëmarrësish.

Numri i punëmarrësve që punojnë pa kontratë individuale pune në këto lloj aktiviteti është shumë i ulët. Janë vetëm 159 punëmarrës që gjatë inspektimeve rezultuar të punojnë pa kontratë pune individuale nga 24876 punëmarrës në total.

Numri i punëmarrësve evidentuar të punonin informal është 50 për të cilët nëpërmjet marrjes së masës urgjente “Pezullim” të punës së tyre në 52 subjekte, deri në formalizimin dhe deklarimit pranë Tatim-Taksave, tashmë ato rezultojnë të futur në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Rreth 38.5% e punëmarrësve të evidentuar në punë në fasoneri rezultojnë që kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritet mbi pagë minimale dhe 0.21 % rezultojnë që të punojnë në turn të dytë.

Nr	Dega	Subjekte	Nr. P/M	Nr i Punëm, në turn të II-të (19 <sup>00</sup> 22 <sup>00</sup> )	Nr i Punëmen 18 vjeç	Nr i Punëm, pa kontrate individuale	Nr. Punëm, të pa siguruar	Nr. Punëm, qe u futen ne skemen e Sig	Nr punm, të siguruar me page min.
1	Berat	12	2288	3	0	0	0	0	1696
2	Dibër	3	243	4	0	1	1	1	45
3	Durrës	30	2395	0	4	0	0	0	0
4	Elbasan	8	343	0	0	0	0	0	269
5	Fier	20	2951	0	0	0	0	0	1948
6	Gjirokastër	5	193	0	0	10	0	0	134
7	Korçë	25	1076	0	0	24	24	24	477
8	Kukës	1	103	0	0	0	0	0	101
9	Lezhë	15	2371	40	12	92	14	14	1265
10	Shkodër	18	1878	0	7	1	1	1	1094
11	Tirane	70	8683	0	0	2	5	5	1592
12	Vlorë	24	2352	5	27	29	5	5	980
	<b>Total</b>	<b>231</b>	<b>24876</b>	<b>52</b>	<b>50</b>	<b>159</b>	<b>50</b>	<b>50</b>	<b>9601</b>

Nga 231 subjekte Fason të inspektuara gjatë kësaj periudhe 47 kanë marrë masën administrative paralajmërim, dhe 6 subkete me sanksion në vlerën 1 720 000 lekë.

Dega	Subjekte	Masë urgjente për marrëdhënie pune	Masë urgjente për sigurinë në punë	Paralajmërim	Sanksion	Vlerë e gjobës (.000)
Berat	12	0	1	5	0	0
Dibër	3	1	0	0	0	0
Durrës	30	0	0	3	1	100
Elbasan	8	0	0	0	0	0
Fier	20	0	0	2	0	0
Gjirokastrë	5	0	0	0	0	0
Korçë	25	3	0	4	0	0
Kukës	1	0	0	1	0	0
Lezhë	15	3	0	5	1	520
Shkodër	18	0	0	0	1	480
Tiranë	70	5	1	6	2	520
Vlorë	24	3	0	21	1	100
<b>Total</b>	<b>231</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>47</b>	<b>6</b>	<b>1720</b>

Fenomen evident në këto lloj aktiviteteve është numri i punëmrrësve-kursantë. Kështu nga të dhënat e inspektiveve rezultojnë gjithsej 2570 kursantë nga të cilët 143 janë kursantë të marrë përmes Zyrave të Punësimit dhe 2427 rezultuan kursantë të kontaktuar drejtpërdrejtë nga vetë subjektet.

Dega	Subjekte	Nr. P/M	Nr i Punëm Kursante, mare përmes zyres së punës	Nr i Punëm Kursante kontaktuar drejtpërdrejtë nga subjekti
Berat	12	2288	20	0
Dibër	3	243	25	0
Durrës	30	2395	0	0
Elbasan	8	343	0	0
Fier	20	2951	21	0
Gjirokastrë	5	193	25	0
Korçë	25	1076	0	0
Kukës	1	103	0	0
Lezhe	15	2371	0	2371
Shkodër	18	1878	0	0
Tiranë	70	8683	3	1
Vlorë	24	2352	49	55
<b>Total</b>	<b>231</b>	<b>24876</b>	<b>143</b>	<b>2427</b>

- **Inspektimet në Media**

Inspektimet u ushtruan në të gjitha qarqet, që mbuloheh nga 12 Degët Rajonale të ISHPSHSH-së ku si rezultat u kontrolluan 47 **subjekte mediatike private e shtetërore**, me 472 punëmarrës të evidentuar ose mesatarisht 10 punëmarrës për subjekt.

Sipas degëve rajonale inspektimet e kryera gjatë vitit 2019 rezultojnë:

<i>Deget Rajonale</i>	Total Inspektime (Media)	Punëmarrës të evidentuar	Punëmarrëse femra
<i>Berat</i>	2	2	0
<i>Dibër</i>	0	0	0
<i>Durrës</i>	3	6	4
<i>Elbasan</i>	10	55	25
<i>Fier</i>	6	11	3
<i>Gjirokastrë</i>	4	48	17
<i>Korçë</i>	4	8	0
<i>Kukës</i>	2	15	5
<i>Lezhë</i>	0	0	0
<i>Shkodër</i>	5	36	7
<i>Tiranë</i>	5	224	79
<i>Vlorë</i>	6	47	16
<b>Total</b>	<b>47</b>	<b>472</b>	<b>164</b>

Nga të dhënat e inspektimeve rezultojnë se nuk ka të punësuar nën 18-vjeç, ndërkohë që punëmarrës me kohë të pjesshme rezultojnë 3 punëmarrës ose rreth 0.5% e punëmarrësve në total.

Në lidhje me zbatueshmërinë e legjislacionit të punës në drejtim të marrëdhënieve të punës gjatë inspektimeve të kryera në këto aktivitete kanë rezultuar këto shifra:

- Punëmarrës me kontrata individuale pune të lidhura janë në masën 98 %
  - Punëmarrës evidentuar në punë në turn të dytë në kuptim të Kodit të Punës janë në masën 8 %.
  - Punëmarrës evidentuar në punë në turn të tretë në kuptim të Kodit të Punës janë në masën 0.2 %
  - Punëmarrës informal të evidentuar janë 4 e ku 2 ishin punëmarrëse femra, dhe tashmë me marrjen e masave ligjore gjatë procesit të inspektimit këta punëmarrës janë pjesë e kontributeve shoqërore e shëndetësore.
  - Rreth 9 % e punëmarrësve janë konstatuar të punojnë mbi 40 orë në javë.
  - Rreth 1.2 % e punëmarrësve janë konstatuar të punojnë mbi 48 orë në javë
  - Për 1.5% të punëmarrësve të evidentuar kryejnë leje vjetore të paguar nën 28 ditë kalendarike.
- Për shkejet e evidentuara në 47 inspektimet e kryera në subjektet mediatike, është marrë 1 masë administrative “Pezullim” për shkelje flagrante të dispozitave ligjore për marrëdhënie pune dhe 3 masa administrative “Paralajmërim”.


**Tregues sipas degëve rajonale rezultton:**

Degët Rajonale	Total Inspektime (Media)	Punëmarrës të evidentuar	Punëmarrës me kontrata pune individuale
Berat	2	2	2
Diber	0	0	0
Durres	3	6	6
Elbasan	10	55	55
Fier	6	11	11
Gjirokaster	4	48	48
Korce	4	8	8
Kukes	2	15	15
Lezhe	0	0	0
Shkoder	5	36	35
Tirane	5	224	220
Vlore	6	47	47
<b>Total</b>	<b>47</b>	<b>472</b>	<b>468</b>

Degët Rajonale	Total Inspektime (Media)	Punëmarrës të evidentuar	Punëmarrës që punojnë mbi 40 orë në javë	% e punëmarres që punojnë mbi 40 orë në javë, kundrejt totalit
<i>Berat</i>	<i>2</i>	<i>2</i>	<i>0</i>	<i>0%</i>
<i>Dibër</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0%</i>
<i>Durrës</i>	<i>3</i>	<i>6</i>	<i>0</i>	<i>0%</i>
<i>Elbasan</i>	<i>10</i>	<i>55</i>	<i>0</i>	<i>0%</i>
<i>Fier</i>	<i>6</i>	<i>11</i>	<i>0</i>	<i>0%</i>
<i>Gjirokastër</i>	<i>4</i>	<i>48</i>	<i>9</i>	<i>19%</i>
<i>Korçë</i>	<i>4</i>	<i>8</i>	<i>0</i>	<i>0%</i>
<i>Kukës</i>	<i>2</i>	<i>15</i>	<i>6</i>	<i>40%</i>
<i>Lezhë</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0%</i>



<i>Shkodër</i>	5	36	4	11%
<i>Tiranë</i>	5	224	15	7%
<i>Vlorë</i>	6	47	4	8.5%
<i>Total</i>	47	472	38	8%



*Shkeljet e konstatuara në kontrollet e ushtruara në subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shërbimeve të mediave konsistojnë në lidhje me:*

- **Kodin e Punës “Ligji 7961, datë 12.07.1995” \*i ndryshuar\***

Detyrat e lëna kanë qenë në drejtim të: instrukcionit të punëmarrësve për dhënien e ndihmës së shpejtë; kohëzgjatjes së pushimeve vjetore procedura e dhënies së pushimeve vjetore; pajisjes së subjekteve me mjetet fikëse ndaj zjarrit; përgjegjësisë së punëdhënësit për përcaktimin e rregullave të sigurimit teknik; pajisjes së subjekteve me kutinë e ndihmës së shpejtë; mirëmbajtjes së pajisjeve të punës dhe higjenës; instruktimit për mbrojtjen nga zjarri; kompesimit të orëve shtesë për punën e kryer; dhënien e pagës vetëm nëpërmjet sistemit bankar, dhënien e evidencave për të gjithë elementet e pagës dhe përlllogaritja e saj; lidhja e kontratës së punës në afatet kohore në formë të shkruar dhe forma e përmbajtjes së saj; dokumentet që duhen të paraqiten si kopje e deklaratave të aksidenteve; planin projektin e vendeve të punës; dokumentin e vlerësimit të riskut për çdo vend pune.

- **Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë “Ligji 10237, datë 18.02.2010” \*i ndryshuar\***

Detyrat e lëna kanë qenë në drejtim të: ndihmës së parë numri i personave të trajnuar për dhënien e saj; udhëzimeve në lidhje me zbatimin e dokumentit të vlerësimit të riskut; kushteve të veprimit të punëmarrësit; detyrimeve të veçanta të punëmarrësit për krijimin e mjediseve të

sigurta të punës dhe njoftimi i punëdhënësit për çdo rrezik pune; hartimit dhe përpilimit të një dokumenti vlerësim risku me karaktere teknike, higjieno –sanitare, të cilat duhet të zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës; mbulimit me shërbim mjekësor nëpërmjet mjekut të punës; informimit të punëmarrësve për çdo rrezik në vendin e punës; mbrojtjen kundër zjarrit dhe evakuimin e punëmarrësve; hartimit të një plan evakuimi dhe shpëtimi në situatë emergjente; sigurimit të funksionimit të vazhdueshëm të sistemeve dhe mjeteve mbrojtëse.

▪ **Ligjin për Nxitjen e Punësimit “Ligji 7995, datë 20.09.1995” \*i ndryshuar\***

Detyrat e lëna kanë qenë në drejtim të: detyrimeve të punëdhënësit për të deklaruar pranë zyrave të punësimit çdo vend të lire pune; detyrimeve të punëdhënësve për të deklaruar pranë zyrave të punësimit ku ushtrohet aktiviteti; çdo punëdhënës është i detyruar të raportojë çdo tre muaj pranë zyrave të punësimit; plotësimin të librezave të punës. Ky ligj është përmirësuar detyra e lënë aktualisht janë shfuqizuar si rezultat i përmirësimit të kuadrit ligjor.

▪ **VKM-së nr. 639, datë 07.09.2016 “Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”**

Detyrat e lëna kanë qenë në drejtim të: punësimit të punëmarrësve, bazuar në raportin e lëshuar nga komisioni mjekoligjor pranë çdo qendre shëndetësore, i cili dorëzohet vetëm në momentin e fillimit të punës

▪ **VKM-së nr. 461, datë 22.07.1998 “Regjistri për Aksidentet në Punë dhe Sëmundjet Profesionale”**

Detyrat e lëna kanë qenë në drejtim të: pajisjes të këtij sektori me regjistrin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale.

Gjatë inspektimeve të kryera në subjektet ku janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore, është ndërmarrë dënimi administrativ kryesor me paralajmërim, duke e konsideruar si një fazë të re inspektimin pranë këtyre subjekteve, dhe duke ndjekur etapat e inspektimit siç përcaktohen në ligj. Jemi shumë të qartë që kemi reflektuar ndër vite mangësi të mëdha të inspektimit në këtë sektor.

Sa i takon problematikës që shoqëron sektorin kjo problematikë më së shumti lidhet me marrëdhëniet e punës dhe çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë duke pasur si fokus ndërtimin dhe formalizimin e kushteve dhe marrëdhënieve të punës mes punëdhënësve dhe punëmarrësve . Fokusi ynë për këtë sektor, sunon të rritë dhe ndërgjegjësojë duke evidentuar punësimin informal, pagesën sipas legjislacionit shqiptar për punën e kryer në turnin e II dhe të III, ditën e pushimit javor si dhe në ditët e festave zyrtare .

Sigurisht që me këto kontrole të kryera nuk pretendojmë që kemi ezauruar plotësisht respektimin e dispozitave ligjore, pasi tregu i punësimit shoqërohet nga një dinamikë e vazhdueshme e

ndryshimit të raporteve të punësimit. Vetë marrëdhëniet e punësimit brenda subjekteve mediatike janë të disa niveleve në kontraktim.

Vetë specifika e ciklit dhe mënyrës së punës e cila shtrihet dhe ka pikun e saj në ditë festave zyrtare, apo ditë të pushimit javor, punë në turne na bën të kemi një nivel të shtuar vështirësie në kontrollin ezaurues në këtë sektor.

## DREJTORIA E STANDARTEVE SHOQËRORE

### • INSPEKTIMI I STANDARTEVE SHOQËRORE

#### Misioni

- ✓ Drejtorja e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- ✓ Drejtorja e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore ka përgjegjësi të kontrollojë dhe të verifikojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

#### Detyrat e Drejtorisë

- ✓ Drejtorja e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore ka si detyrë kryesore inspektimin e të gjithë strukturave të shërbimit, duke filluar nga bashkitë (Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore, shërbimet komunitare, shërbimet në familje, kujdestaritë), shërbimet rezidenciale, ditore, shërbimet e kujdestarisë familjare, shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve nga NjMF-të, ndërmarrjet sociale, si dhe çdo lloj shërbimi komunitar, për respektimin e standarteve të miratuara me VKM.
- ✓ Vlerësimi i standarteve për subjektet që duhet të liçensohen.
- ✓ Inspektimi i ankesave dhe kërkesave të përfituesve dhe strukturave, të cilat kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- ✓ Mbajtja, përditësimi i një baze të dhënash për shërbimet, subjektet, njësitë vendore, NjMF-të si dhe inspektimet e kryera.

### Arritjet kryesore të vitit 2019

Bazuar në bazën e të dhënave që Drejtorja e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore disponon, informacioni i së cilës, përditësohet nga inspektimet e kryera, evidentohen të ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror një numër prej 311 subjekte publike dhe jopublike, (97 shërbime rezidenciale, 95 qendra ditore, 12 qendra multidisiplinare dhe 107 shërbime komunitare).

#### Objektivat dhe realizimi për vitin 2019

	Objektivi	Aktiviteti	Treguesi i synuar	Realizimi
1	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror , garantimi i respektimit të standarteve të shërbimeve, më qëllim respektimin e të drejtave të përfituesit dhe mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna,	<b>Inspektimi i qëndrave të përkujdesit shoqëror</b>	<b>120</b>	<b>126</b>

	abuzimi, duke vlerësuar si prioritet forcimin e mekanizmave, procedurave të mbrojtjes si edhe rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj procesit të ankimimit.			
2	Njohja dhe respektimi i standarteve të shërbimeve, rritja e kujdesit, por edhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve komunitare, në përputhje me nevojat e gjithë komunitetit, nëpërmjet inspektimit të qendrave të krijuara nga bashkitë në kuadër të rolit dhe të përgjegjësisë të marra nga bashkitë me Ligjin e Ri Nr.121/2016.	Takime me strukturat e bashkisë dhe vlerësimi i situatës së përgjithshme të shërbimeve të reja.	10 bashki	10 bashki, 14 njësi shërbimi të përkujdesit shoqëror

Realizimi i Planit për vitin 2019 është i lidhur ngushtë me një proces planifikimi bazuar në indikatorët si më poshtë:

- Zhvillimi i një procesi diskutimi, ku përishiet i gjithë stafi në hartimin e ProjektPlanit, duke maksimalizuar ekspertizën dhe njohjen e terrenit;
- Përcaktimi i objektivave të qarta, dhe prioriteteve;
- Historiku i subjektit, (koha nga inspektimi i kaluar, detyrat e masat e lëna);
- Niveli i ekspozimit të përfituesit nga diskriminimi, dhuna dhe abuzimi, në varësi nga tipologjia e përkujdesjes;
- Kontaktimi dhe marrja e informacioneve paraprake për ecurinë apo programet e punës së strukturave sociale të bashkive;
- Vlerësimi i çdo informacioni, (formal, mediatik apo dhe informacion informal), për zhvillimet, apo qendrat e reja të krijuara nga bashkitë;
- Analiza e trendit të tipologjisë së shërbimeve të reja, apo e trendit të problematikave të ndeshura;
- Përditësimi i vazhdueshëm, pas çdo inspektimi, i bazës së të dhënave të subjekteve.

Arritjet dhe rezultatet e vitit 2019 kanë qenë rrjedhojë e një planifikimi të mirë që ka ardhur nga marrja parasysh e këtyre indikatorëve.

### **Analiza e treguesve numerik të realizimit të planit për vitin 2019.**

#### **➤ Inspektime**


Përgjatë vitit 2019, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore i është përmbajtur inspektimit të planifikuar, bazuar në objektivin vjetor dhe planin mujor të inspektimit. Kështu, për vitin 2019, u planifikua inspektimi i standarteve të përkujdesit shoqëror në 120 qendra rezidenciale, ditore dhe komunitare.

Në zbatim të planit mujor të inspektimit, gjatë vitit 2019 u realizua inspektimi i 119 qendrave të përkujdesit ditor, komunitar dhe rezidencial. Gjithashtu, u realizua inspektimi i paplanifikuar në 7 qendra të tjera, (*Grafik 1*).

Inspektimet e paplanifikuara u realizuan në zbatim të procedurave të liçensimit, (Udhëzimi Nr.2 me datë 10.03.2014 “Për procedurat e Shqyrtimit të Kërkesave për Liçensimin të Subjekteve që kryejnë veprimtari të Përkujdesit Shoqëror”), dhe në 2 raste inspektimi i paplanifikuar u realizua për arsye verifikimi apo trajtimi ankese.

○ Planifikuar inspektime	<b>120</b>
○ Inspektime të planifikuara	<b>119</b>
○ Inspektime të paplanifikuara	<b>7</b>
○ Inspektime gjithsej të realizuara	<b>126</b>

**Grafik 1. Krahasimi i inspektimeve të planifikuara me ato të paplanifikuara në 2019**



➤ **Takimet me strukturat e përkujdesit shoqëror në bashki.**

Për periudhën Janar – Dhjetor 2019 u realizuan 10 takime të planifikuara me Drejtoritë e Shërbimit Social në Bashki. Në vijim të njohjes së zhvillimeve në këto drejtori, në drejtim të krijimit të shërbimeve të reja, kryesisht komunitare, u vlerësua situata e përgjithshme e qendrave apo njërive të reja të shërbimit, të krijuara nga këto bashki, vetë apo në partneritet me organizata ndërkombëtare apo lokale. Kështu u realizua identifikimi, vlerësimi dhe informimi me standartet në 14 qendra/njësi shërbimi të kujdesit shoqëror.

➤ **Trajtimi ankesave**

Gjatë vitit 2019, pranë Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore **u deleguan 2 ankesa**, nga të cilat 1 e ardhur nga Portali i Bashkëqeverisjes, dhe 1 nga Akovati i Popullit/Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

**Të 2 rastet u trajtuan.** Rasti i Qendrës Komunitare Malteser Lezhë, (ankesë e deleguar nga Portali i Bashkëqeverisjes), pretendimi i ankuesit nuk qëndron. Në një rast, (Shtëpia e Foshnjës 0-6 vjeç Vlorë), nuk ka shkelje ligjore dhe të standarteve, nga ana e qendrës së përkujdesit, por

u dhanë rekomandime për Bashkinë Vlorë për plotësimin e 6 vendeve të lira në stafin e qendrës, me prioritet.

- Numri i përfituesve dhe tipologjitë e shërbimeve të qendrave, të cilat përgjatë vitit 2019 u inspektuan apo të qendrave të reja të identifikuara e të vlerësuara, janë si më poshtë:

Shërbime të kujdesit rezidencial: **1149** (fëmijë, PAK, të moshuar, viktime të dhunës në familje, familje në situatë emergjence, etj);


Shërbime të kujdesit komunitar: **6816** (fëmijë, PAK, të moshuar, viktime të dhunës në familje, individë apo familje në situatë emergjence, etj);

Treguesit krahasues për 2018 dhe 2019 në mbështetje të këtij konkluzioni, janë në tabelën dhe grafikët në vijim.


Viti	Qendra Perkujdesi Rezidencial		Qendra Perkujdesi Komunitar	
	Inspektime (nr.)	Përfitues (nr.)	Inspektime (nr.)	Përfitues (nr.)
2018	45	1167	73	4109
2019	60	1149	80	6816

Në vitin 2019 u inspektuan 25% më shumë qendra të shërbimit rezidencial, krahasuar me vitin 2018, dhe 9% më shumë shërbime komunitare, (*Grafiku 2*). Krahasimi për këto vite, i numrit të përfituesve në qendrat e perkujdesit rezidencial është zvogëluar dhe numri përfituesve që marrin shërbime komunitare, në qendrat e inspektura dhe qendrat e reja të vlerësuara, përgjatë vitit 2019, është 65% më i madh, ose 2707 individë në nevojë më shumë, (*Grafiku 3*). Kjo rritje e numrit të përfituesve të shërbimeve komunitare është e lidhur me rritjen e numrit të shërbimeve të komunitare, kryesisht atyre të reja, shumëdisiplinore, të krijuara nga bashkitë. Identifikimi, vlerësimi, njohja dhe informimi ligjor i Drejtorive të Shërbimit Social në Bashki dhe i qendrave/njësiteve të shërbimit, i vendosur si një nga prioritetet e punës së Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërorë rezultoi, kështu, një reagim në kohë dhe i sukseshëm.

**Grafik 2.** Numri krahasimor për vitet 2018 dhe 2019, i qendrave të inspektuara apo vlerësuar situata e përgjithshme, të ndara sipas tipologjisë së shërbimit, (përkujdes rezidencial dhe përkujdes komunitar).



**Grafik 3.** Numri krahasimor për vitet 2018 dhe 2019, i përfituesve në qendrat e inspektuara apo vlerësuar situata e përgjithshme, të ndara sipas tipologjisë së shërbimit, (përkujdes rezidencial dhe përkujdes komunitar).



- Përsa i takon shpërndarjes gjeografike të inspektimeve, përgjatë vitit 2019, u planifikuan dhe u realizuan, përgjithësisht Qarqet dhe Bashkitë me numër të madh shërbimesh dhe me informacione paraprake të marra për iniciativat e bashkive për të krijuar shërbime të reja komunitare. Kështu, gjatë vitit 2019 Qarqet në të cilat janë realizuar programe inspektimi janë: Dibra, Durrësi, Elbasani, Fieri, Korça, Kukësi, Shkodra, Tirana dhe Vlora.

### **Inspektimi i Standarteve, zhvillimet pozitive dhe problematikat.**

Në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar duke ndjekur një proces plotësimi të kriteve të standarteve të shërbimit, sipas tipologjisë së tij, apo standarteve të përgjithshme të aplikuara në mungesë të standarteve të rrjedhura nga Ligji i Ri Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nga inspektimet e realizuara gjatë vitit 2019, konstatohen arritjet si më poshtë:

1. Si një tregues mjaft i rëndësishëm i cilësisë së shërbimit është zbatuar përgjithësisht përmirësimi i strukturave të stafëve të shërbimit me figura profesionale dhe përputhja e tyre me vendin e punës. Është rritur struktura e shërbimit me figura teknike, sidomos në qendrat jopublike që ofrojnë shërbime të specializuara për Personat me Aftësi Ndryshe. Vlerësohet si një rast shumë pozitiv, dhe i pari, në një qendër publike, rasti i Qendrës së Përkujdesit Rezidencial “Shtëpi Familje për të Rinjtë 16-18 vjeç Shkodër”, e cila në strukturë ka 9 punonjës social, që të gjithë me arsimin në fushën përkatëse.
2. Gjatë inspektimeve të bëra në 2019, përgjithësisht, rezulton të jenë realizuar rekomandimet e dhëna në inspektimet e mëparëshme për qendrat publike të përkujdesit rezidencial lidhur me ndërhyrjen në infrastrukturë për përmirësimin e gjendjes fizike të godinave. Veçohet në proces ndërhyrje të qenësishme me shumë impakt në komoditetin dhe cilësinë e jetës së përfituesve në Qendrën e Zhvillimit “Pëllumbat” Tiranë, Qendrën e Zhvillimit Vlorë, “Shtëpinë e Foshnjës 0-5 vjeç Shkodër”, “Shtëpia e të Moshuarve Kavajë”, etj.
3. Një vëmëndje të veçantë, gjatë inspektimeve të vitit 2019, i është kushtuar edhe aksesueshmërisë së shërbimit për personat e pamundur për të lëvizuar. Nga inspektimet rezultoi që përgjithësisht, qendra jopublike janë të aksesueshme, pa barrierë fizike të jashtme, si edhe konstatohen modele shumë të mira aksesueshmësi në ambjenteve të brendshme. Problematikë vazhdojnë të jenë qendrat publike të përkujdesit rezidencial për persona me Aftësi të Kufizuar, si edhe deri diku për qendrat rezidenciale për të moshuarit. Qendrat rezidenciale të ndërtuara hershëm, nuk janë komode, me elementë të aksesueshëm për shërbimin ndaj këtyre personave. Konstatim pozitiv për 2019 në këtë drejtim është që në 3 qendra nga 6 të tilla, me mbështetjen e UNDP-së, si në rastin e Qendrës së Zhvillimit “Pëllumbat” Tiranë, Qendrën e Zhvillimit Vlorë, apo agjensi të tjera, si në rastin e “Shtëpinë e Foshnjës 0-5 vjeç Shkodër”, ku po kryen rikonstruksionin total të godinave me standarte dhe me aksesueshmëri të plotë.
4. Në drejtim të mbrojtjes së të drejtave, trajtimit me dinjitet të përfituesve, mbrojtjes së tyre nga dhuna, abuzimi, neglizhimi, sikurse ka qenë një nga objektivat e drejtorisë, përgjatë inspektimeve të kryera në 2019, ka mbështetur të gjitha masat administrative të marra nga drejtuesit e institucioneve, kryetarët e bashkive në drejtim të punonjësve të shërbimit. Në rastet e dyshuara, inspektorët kanë hulumtuar të gjithë dokumentacionin e qendrës, ka vlerësuar procedurat e ndjekura nga ekipet multidisiplinare dhe në një rast bazuar në Ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Neni 52, pika 3, si dhe aktet akoma të pandryshuara të Ligjit Nr.9355 datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, dhe VKM Nr.512, datë 31.05.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të Shërbimeve Shoqërore” Kreu I pika 8, shkronja “d” dhe Kreu II pika 4, shkronjat b), c), ç); ka propozuar dhënjen e masës “largim nga puna” për një kujdestare në Shtëpia e Fëmijës Shkollor “Vangjel Pulla” Sarandë. Konstatimi dhe arsyeja e masës së dhënë ishte neglizhimi në kryerjen e detyrës, me pasojë vendosjen në situatë rreziku për jetën e dy fëmijëve të institucionit.



Me qëllim forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe të parandalimit të dhunës, abuzimit, neglizhimit, shkeljes së të drejtave të përfituesve, me prioritet në qendrat e shërbimit të përkujdesit rezidencial, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, në inspektimet e bëra përgjatë 2019, ka lënë detyrë hapjen e regjistrit për të regjistruar në mënyrë të vazhdueshme rastet dhe procedurat e kryera për sqarimin e çdo rasti, pavarësisht se është ngjarje, është incident apo është dyshim. Hulumtimi i të gjitha rasteve si edhe monitorimi i stafit, është kërkesë e Standarti Nr.X. VKM Nr.659, datë 17.10.2005, “Për Standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”. Pavarësisht praktikave të mira të ndjekura nga institucionet, konstatohet që stafi dhe drejtuesit tyre lënë gjurmë në mënyra të ndryshme dhe të shpëputura lidhur me incidentet e ndodhura. *Rregjistri i rekomanduar nga Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore është një pasurim i listës së treguesve të plotësimi të standartit të sipërcituar.*

5. Përsa i takon ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, **të palicensuar, janë evidentuar 21 subjekte, nga të cilat 18 janë shërbime publike.**

- Përsa i përket shërbimeve të ofruara nga organizatat, (shërbimet jopublike), 3 prej tyre, që rezultuan të papajisur me liçensë janë shërbime të reja, të inspektuara apo vlerësuara për herë të parë. Vetëm një ofrues shërbimi, Organizata “Gruaja tek Gruaja”, Shkodër, *u konstatua se nuk ka realizuar detyrën për pajisjen me liçensë për ofrimin e shërbimit të përkujdesit rezidencial, për të cilën u paralajmërua dhe i’u bë me dije se mosmarrja e masave për pajisjen me liçensë, një detyrë e porealizuar, do të bëjë shkak për të propozuar masa administrative, sikurse parashikon Ligji Nr.121/2016, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.*
- Përsa i përket shërbimeve publike, rezultoi në 17 raste mospajisja me liçensë. Nga këto 3 janë shërbime të reja të inspektuara apo vlerësuara për herë të parë. Evidentohet si më problematike mospajisja me liçensë e qendrave rezidenciale publike, ish-qendra kombëtare, të transferuara nga varësia e SHSSH, në varësi dhe administrim nga Bashkitë. Shumë prej këtyre nuk kanë arritur të bëjnë aplikimin në sportelin përkatës të QKB-së, për mungesë apo pasaktësi dokumentacioni, veçanërisht atë të pronësisë së godinës. Të tilla institucione janë 9, konkretisht: *Shtëpia e Foshnjës Vlorë, Qendra Rezidenciale Zhvillimit Vlorë, Shtëpia e Fëmijës “Vangjel Pulla” Sarandë, Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli” Tiranë, Qendra Rezidenciale “Pëllumbat” Tiranë, Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, Qendra e Zhvillimit Mendor Shkodër, Qendra Kombëtare Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, Qendra e Zhvillimit Bashkia Lushnje.*

Nga rekomandimet e vazhdueshme të inspektimeve dhe i të gjithë aktorëve, që kanë lidhje me liçensimin, për vitin 2019 u arrit të vihet në lëvizje procesi i liçensimit të qendrave rezidenciale publike. Janë liçensuar në afat 3 qendra të tilla. Me praktikën e sukseshme të Qendrës Rezidenciale të Zhvillimit Durrës janë informuar, orjentuar edhe qendrat e tjera. Mbeten edhe 9 qendra të palicensuara.

Institucioneve publike të sipërcituara dhe bashkive përkatëse, në cilësinë e administratorit të tyre, i'u bë me dije, se mosmarrja e masave në vijim, për pajisjen me licensë do të përbëjë shkak për të propozuar masa administrative, sikurse parashikon Ligji Nr.121/2016, datë 24.11.2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

6. Edhe për vitin 2019 rezulton i realizuar rekomandimi i dhënë në inspektimet e mëparëshme në drejtim të respektimit të procedurave të Ankimimit, si një çështje dhe praktikë e rëndësishme e standarteve të shërbimeve shoqërore, si masë paraprake në luftën kundër abuzimit me përfituesin e shërbimit. Në inspektimet dhe vlerësimet e situatës së përgjithshme të kryera gjatë vitit 2019, vetëm në qendrat e reja të shërbimit, dhe këto jo në të gjitha rastet, u rekomandua të vendoset Kutia e Ankimimit dhe të aplikohet hapja për çdo muaj, me komision. Në këtë drejtim, janë sensibilizuar edhe bashkitë për rëndësinë e këtij procesi.
7. Janë plotësuar rekomandimet, rast pas rasti, për plotësimin e dosjeve të përfituesve dhe kryerjen periodike të vlerësimeve të nevojave dhe Planit Individual.
8. Janë plotësuar rekomandimet, rast pas rasti, për zbatimin e procedurave të pranimit në institucion. Përgjithësisht, në institucionet rezidenciale për fëmijë, pranimet e vitit 2019, janë kryer si referime dhe praktikat e komisionimit janë ndjekur nga Grupi i Vlerësimit të Nevojave, strukturë përgjegjëse, e re, në Bashki.
9. Është konstatuar zbatimi, nga të gjithë institucionet publike dhe jopublike, i rekomandimit të lënë për plotësimin e dosjeve të stafit, kryesisht me Dëshmi Penaliteti të punonjësit, me vlerësim të performancës së punonjësit, si dy dokumente më të neglizhuar në plotësimin e dosjes personale.
10. Përgjatë vitit 2019 Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore ka bashkëpunuar me institucionet dhe aktorë të tjerë, të përfshirë në ofrimin e shërbimeve, në politikëbërjen e përkujdesit shoqëror dhe të monitoruesve të të drejtave të njeriut. Kështu, veçojmë:
  - Raportimi dhe referimi i problematikave të konstatuara, njëpërnjë, për çdo muaj, MSHMS, SHSSH, Kryetarëve të Bashkive, të Këshillave të Qarkut përkatës, në territorin e të cilëve, është ushtruar kontroll.
  - Përgatitja e informacioneve të ndryshme, dergimi i të dhënave për licensimin, listave të institucioneve publike dhe jopublike, të kërkuara nga MSHMS për nevojat e saj apo për agjensi të tjera. Drejtoria i është përgjigjur, gjithnjë në kohë, MSHMS, bazuar në informacionet e mbledhura nga inspektimi, edhe pse burimi kryesor i informacionit të kërkuar, bazuar në VKM-të përkatëse, nuk është Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, apo ISHPSHSH-ja.

- Verifikimi dhe informimi për shqetësimet të ngritura nga Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Unicef, Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, etj.
- Bashkëpunimi me ekspertin e Këshillit të Europës, për analizën dhe rekomandimet lidhur me përgatitjen nga ana e këtij komisioni të Strategjisë së Reformës Sociale 2020–2023.

11. Në kuadër të bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të personave, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, në muajin Tetor 2019, konceptoi, drejtoi dhe monitoroi 8 aktivitete sensibilizuese për çështjet e trafikimit, punës së detyruar, referimit dhe parandalimit, me rreth 600 të punësuar. Aktivitetet u zhvilluan nga Degët Rajonale të ISHPSHSH-së. Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, e koordinojë dhe i përfshiu këto aktivitete, me kërkesë të të Koordinatorit Kombëtar të Luftës Kundër Trafikimit të Personave. Në këto aktivitete u bashkëpunua edhe me organizata ndërkombëtare, aktorë me ekspertizë në këtë fushë.

12. Në drejtim të rritjes së kapaciteteve të stafit, në bashkëpunim me Fondacionin Terre des hommes, Misioni Shqipëri, u mundësua që stafi i Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, ka marrë pjesë në **Trajnimin e Trajnerëve** “Për ngritjen dhe menaxhimin e Modelit të Qendrave Komunitare Multifunksionale”, (ToT of MFCC). Qëllimi i këtij trajnimi është krijimi i një grup ekspertësh dhe trainerësh, të cilët do të shërbejnë si një grup burimesh që forcojnë këto shërbime në zonën gjeografike, ku ata punojnë dhe në nivelin kombëtar bazuar në modelin e hartuar nga Tdh dhe standardet e funksionimit për këtë lloj shërbimesh. U vlerësua shumë i rëndësishëm, dhe në përputhje me objektivin dhe prioritetin e Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, që është forcimi i kapaciteteve të strukturave lokale, (bashkive), dhe i shërbimeve të reja komunitare të ngritura nga bashkitë, në rrjedhim të përgjegjësive të ngarkuara nga Ligji Nr.121/2016, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

## VII.PUBLIKIME

**Publikimet dhe fushatat publicitare të realizuara nga Inspektorati shtetëror I Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për periudhën janar-dhjetor 2019.**



**Më datë 14 Janar 2019**, pranë ambjenteve të Kryeministrisë, me vëmendjen e veçantë të Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Kryeinspektori, Z. Arben Seferaj, në prani të sipërmarrjes në prani të përfaqësuesve të sipërmarrjes, prezantoi platformën transparencës **Matrica e Dënimeve**.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në kuadër të angazhimit mbi gjetjen e mekanizmave për vendosjen e standarteve në punë, për rritje të transparencës në marrëdhëniet me biznesin, duke i shërbyer gjithmonë motos **“më pak abuzim me ligjin”**, ka projektuar një shërbim online, mundësi testimi për çdo subjekt, në lidhje me zbatimin e Legjislacionit të Punës, duke krijuar mundësinë e vetëkorrigjimit.

Kjo platformë, si risi e cila ka kërkuar orë pune e përkushtimi, për gjetjen e një metodologjie të aplikueshme me mundësi:

- Testimi i çdo punëdhënësi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të punës, duke krijuar mundësinë e vetëkorrigjimit.
- Rritje e inteligjencën profesionale të inspektorëve të punës, transparencë në vendimarrjen e tij, minimizim i abuzimit me detyrën.
- Trajtim i barabartë, për mos respektimin e të njëjtës dispozitë ligjore, në kushte të barabarta.

Përgatitja e një matrice të detajuar, theksoi Z. Seferaj, me të gjitha funksionet inspektuese e vendimarrëse, inventarizimi i plotë i kuadrit ligjor-rregullativ të inspektimit të punës dhe bërja e aksesueshme e saj, për të gjitha grupet e interesit (biznese, shoqata, inspektorë), do të përmirësojë efikasitetin e inspektimeve si dhe forcimin e rolit rregullator të tyre.

### **Memorandum Bashkëpunimi ISHPSHSH-AMA**



Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në datë 28.02.2019 nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit me Autoritetin të Mediave Audiovizive për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin, për çështje të interesit të përbashkët, që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve që punojnë në fushën e mediave audio dhe/ose vizive.

Ky memorandum do të shërbejë për shkëmbimin e përvojës dhe informacionit të të dyja institucioneve, me qëllim forcimin e kontrollit të punës në këtë sektor, si dhe respektimin e të drejtave të punëmarrësve për kushtet e punës, mbrojtjen e tyre në ushtrimin e profesionit, pagat, sigurimin dhe mirëqënien në vendin e punës.

### **Marrëveshje Bashkëpunimi ISHPSH-KMD**

Kryeinspektori i Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, z. Arben Seferaj dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Robert Gajda nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, për të bashkërenduar të gjitha veprimet për të realizuar mbrojtjen e punëmarrësve kundrejt diskriminimit në punë.

Kjo marrëveshje do të shërbejë për institucionalizimin, midis palëve për të siguruar ndihmën reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit, sinjalizimit të rasteve diskriminuese e bashkëpunimit midis dy Institucioneve, në kuadër të marrjes së masave pro aktive për mbrojtjen nga Diskriminimi në Punësim dhe Fushën e Shërbimeve Shoqërore, si dhe për promovimin e parimit të barazisë. Marrëveshja parashikon trajtimin e ankesave me inspektime të përbashkëta në raste të caktuara.

### **Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi – Ballkani Perëndimor**

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit nëpërmjet inspektorateve të punës të ballkanit perëndimor. Një takim i nivelit të



lartë rajonal të Drejtorëve të Inspektorateve Kombëtare të Punës (LI) në Ballkanin Perëndimor u organizua në Tiranë më 27-28 Mars 2019, në kuadër të projektit rajonal “Platforma e Punësimin dhe Çështjeve Sociale në Ballkanin Perëndimor” (ESAP), zbatuar nga ILO dhe financuar nga EU.

Qëllimi:

- Të ndajë rezultatet dhe eksperiencën e fushatave të Inspektorateve të Punës në kuadër të ESAP.
- Të ndajë përvojat, në lidhje me rolin e inspektorateve të punës në zbulimin dhe parandalimin e punës së padeklaruar, si një përgatitje për vazhdimin e projektit (ESAP 2).
- Krijimi i një kornize formale për një Rrjet (Network) të Inspektorateve të Punës të Ballkanit Perëndimor.

## Marrëveshje Bashkëpunimi ISHPSHSH-APP, në funksion të zbatimit të Kodit të Punës.



### *Përmirësimi i ndërgjegjësimit publik dhe promovimi i politikave të SSHP-së.*

Takim informues në kuadër të fushatës Europiane për vende pune të shëndetshme & menaxhimi i substancave të rrezikshme

Në kuadër të Fushatës Europiane 2 vjeçare 2018-2019, e udhëhequr nga EU-OSHA, me temë “Menaxhimi i substancave të Rrezikshme”, e cila synon të rrisë vetëdijen për rreziqet e paraqitura nga substanca të rrezikshme në vendin e punës dhe të promovojë një kulturë të parandalimit të rreziqeve, janë kryer këto aktivitete:

- Shpërndarja e fletë-palosjeve, broshurave dhe posterave në të gjitha Degët Rajonale të ISHPSHSH-së.
- Shpërndarja e fletë-palosjeve, broshurave dhe posterave në subjekte të ndryshme, në të cilat përdoren substanca të rrezikshme.
- Organizimi i dy tryezave të rrumbullakta me rreth 76 përfaqësues të subjekteve të ndryshme dhe inspektorë pune të të gjithë Degëve Rajonale të ISHPSHSH-së, përkatësisht në rrethet Elbasan dhe Shkodër.
- Pjesëmarrje aktive në tryezat e rrumbullakta dhe takime të ndryshme të organizuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), AMA, Qendra e Aleancës Gjinore e Zhvillim, Qendra për të Drejtat në Punë, Together for Life, Qendra Shqiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Kryqi i Kuq Shqiptar, sindikata të punëdhënësve dhe punëmarrësve, për promovimin dhe ndërgjegjësimin publik në raport me zbatueshmërinë e legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe të gjithë Legjislacionit të Punës në tërësi.
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët me punëdhënës të aktivitetit call-centër, organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë , në lidhje me problematikat që has ky sektor, për zbatueshmërinë e Legjislacionit të Punës.



*Aktivite informuese në  
subjekte*



## **VIII.PROBLEMATIKA TË HASURA**

Problematika që shoqërojnë procesin e inspektimit i evidentojmë si më poshtë:

Rezultuan 494 subjekte të planifikuara për inspektim edhe pse ishin me status aktiv në QKB, të mos ushtronin aktivitet ekonomik në fakt.

- Numri i inspektorëve të punës në terren krahasimisht me numrin e aktiviteteve objekt kontrolli vazhdon të jetë i ulët
- Duke qenë se nuk pati asnjë ndryshim strukture apo rishikim të strukturës ekzistuese, kërkesë e vazhdueshme e ISHPSHSH-së, pjesë e raportit të 2018, është bërë një riorganizim në ndarjen e detyrave për monitorim pune në inspektorët e Drejtorisë Qendrore.
- Për 10 nëpunës civil janë marrë masa disiplinore për shkelje të konstatuara
- Në tre vite, nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.121/2016, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, janë miratuar akte nënligjore për specifika të veçanta, por rishikimi i standarteve ekzistuese, i standarteve për tipologjitë e reja të përkujdesit, që sjell ky ligj, përfshirë edhe vetë shërbimet sociale të bashkive, nuk janë miratuar, duke sjell realitete dhe progrese spontane në implementimin e shërbimeve të përkujdesit nga bashkitë
- Mos pajisja me licensë e qendrave rezidenciale publike, ish-qendra kombëtare, të transferuara nga varësia e SHSSH, në varësi dhe administrim nga Bashkitë
- Problematikë vazhdojnë të jenë qendrat publike të përkujdesit rezidencial për persona me Aftësi të Kufizuar, përshkak se godinat janë të ndërtuara shumë vite më parë, në modelin e konvikteve
- Në tre vite, nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.121/2016, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, janë miratuar akte nënligjore për specifika të veçanta, por rishikimi i standarteve ekzistuese, i standarteve për tipologjitë e reja të përkujdesit, që sjell ky ligj, përfshirë edhe vetë shërbimet sociale të bashkive, nuk janë miratuar, duke sjell realitete dhe progrese spontane në implementimin e shërbimeve të përkujdesit nga bashkitë
- Mos pajisja me licensë e qendrave rezidenciale publike, ish-qendra kombëtare, të transferuara nga varësia e SHSSH, në varësi dhe administrim nga Bashkitë
- Problematikë vazhdojnë të jenë qendrat publike të përkujdesit rezidencial për persona me Aftësi të Kufizuar, përshkak se godinat janë të ndërtuara shumë vite më parë, në modelin e konvikteve

## **IX.OBJEKTIVA PËR VITIN 2020**

Për vitin 2020 do të realizojmë që përmes platformës “Matrica e Dënimeve”, bazuar në të dhëna historiku inspektimesh, vlerësim të automatizuar të riskut, për çdo subjekt mbi bazë koeficientësh, për orientim planifikimi sipas të dhënave për;

- herët e shkeljes së konstatuar
- shkeljes ligjore të konsumuar
- masave administrative të marra
- periudhës kohore të realizimit të detyrave të lëna për korigjim shkelje



- llojit të aktivitetit e nëaktivitetit
- aksidenteve të ndodhura e numrit të punëmarrësve të aksidentuar
- ankesave të prodhuara për subjekt
- informalitetit të evidentuar
- Orientimi i inspektimeve dhe planifikimi i tyre në bazë risku, vlerësuar nga historiku i inspektimeve në platformën “Matrica e dënimeve”.
- Përdorimi i masave efikase në inspektim duke rritur numrin e subjekteve ligjzbatuese pa qenë ndëshkues e gjobëvënës, por këshillues e orjentues për zgjidhje.
- Kryerja e monitorimit të vazhdueshëm të inspektimeve të programuara dhe jashtë programit me fokus nxjerrjen e problematikave duke i evidentuar me qëllimin e rritjes së cilësisë së inspektimit.
- Monitorimi i të gjitha Degëve Rajonale në aplikimin dhe përdorimin e matricës së dënimeve si një platformë novatore në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
- Synimi i një cilësie të mirë e proceseve dhe produkteve të inspektimit me qëllim rritjen e standartizimit të procesit inspektues.
- Propozimi për përmirësime të dispozitave ligjore për një zbatueshmëri të qartë të tyre.
- Përmirësimi i efektivitetit të proceseve statistikore .
- Rritja e besueshmërisë së publikut për trajtimin e ankesve dhe kthimin e përgjigjes brenda afateve kohore.
- Nxjerrja e të dhënave të inspektimit nga platforma “Matrica e dënimeve”, që është një risi e futur në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
- Trainimi dhe menaxhimi i njohurive për rritjen e cilësisë së mbledhjes së të dhënave sipas parimeve të Kodit të Statistikave Europiane.
- Unifikimi i procedurës inspektuese në evidentimin e informalitetit gri, ku të përfshijë pagën për punën e kryer në turne, ditët e pushimit javor, ditët e festave zyrtare, orët jashtë orarit, respektimin e pagës së përcaktuar në kontratën e punës, deklarimi në sistemin tatimor me pagën reale, deklarimi në sistemin bankar i pagës reale, respektimi i kohëzgjatjes së pushimeve vjetore dokumentimi i dhënies së tyre me procedurë ligjore/ pagesa për pushimet vjetore dhe moszvendësimi i tyre me punë , përlogaritjen e pagës me elementet përbërës së saj, punësimit informal etj.
- Analizimi i problematikave dhe përmirësimi i tyre duke zhvilluar takime dhe trajnime me bizneset duke mbështetur dhe stimuluar nismat e personave private e shtetëror, si dhe duke mirëpritur sugjerimet dhe informacionet e tyre.

- Orinetimi i inspektimeve drejt atyre fushave ku ngrihen probleme dhe kërkohet një fokusim më i madh për zbatimin në mënyrë efektive të ligjit si për marrëdhëniet e punës ashtu edhe për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Synimi i sigurimit të rritjes së inspektimeve dhe trajtimit të problematikave në subjektet shtetërore.
- Evidentimi i llojit të aktiviteteve me problematika në drejtim të zbatimit të legjislacionit të punës dhe përmirësimit të punës inspektuese bazuar në kërkesa sektoriale.
- Përmirësimi i rregullores e brendshme të funksionimit, si dhe përcaktimi i objektivave për 2020 bazuar në detyra konkrete e të matshme për secilin punonjës.
- Plotësimi i vendeve vakante.
- Njohja e zhvillimeve, progresit në drejtim të organizimit të Drejtorive të Përkujdesit Shoqëror në Bashki, njohja e shërbimeve të reja komunitare në përgjigje të komuniteteve në nevojë, të krijuara nga bashkitë, bazuar në kompetencat e dhëna nga Ligji Nr.121/2016
- Inspektimi i 110 shërbimeve të kujdesit shoqëror, me qëllim ruajtjen dhe garantimin e cilësisë së shërbimit në përputhje me plotësimin e standarteve përkatëse të shërbimeve, sipas tipologjisë përkatëse.
- Njohja e zhvillimeve, progresit në drejtim të organizimit të Drejtorive të Përkujdesit Shoqëror në 8 Bashki dhe njohja e shërbimeve të reja komunitare në përgjigje të nevojave të vlerësuara të komuniteteve në nevojë
- Forcimi kapaciteteve inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore